



Adresa: L. "30 Vjetori", tek stadiumi i vjetër  
Tel & Fax ++ 355 32 36 932  
Cel: 069 20 97 685

Viti IV, Nr. 4 (173) E përjavshme e pavarur

E hënë, 12 shkurt 2007

Çmimi 20 lekë ( 1 Euro)

Adresa: Bulevardi "Republika", Shtëpia e Ushtarakeve

Tel: + 069 2247353

Adresa në internet: [www.lajmetari.net](http://www.lajmetari.net)

e-mail: [redaksia@lajmetari.net](mailto:redaksia@lajmetari.net)

### ZGJEDHJE

**Thirrje e kandidatit Sali Hoxha drejtuar qytetarëve të Beratit** [Faqe 3](#)

### ZGJEDHJE

**Kandidati Nasufi: Berati nën drejtimin e socialistëve ka njohur progres** [Faqe 4](#)

### ZGJEDHJE

*Abedin Kaja*  
**Deputeti Taulant Dede: "Jo pazare në kurriz të socialistëve"** [Faqe 5](#)

### PEGAS 2006-2007

**Poezi nga Fatbardh Hoxha** [Faqe 9](#)  
**Opinione nga Agim Mehqemeja dhe Qerim Hysenbegasi** [Faqe 6](#)  
**Sport nga Vlash Pambuku dhe Vangjel Buda** [Faqe 16](#)

### EDITORIAL

## Më i rëndësishëm se rezultati është standardi

Shqipëria ende nuk ka zhvilluar zgjedhje të lira dhe të ndershme, zgjedhje që të konsiderohen nga institucionet ndërkombëtare si krejt korrekte dhe në përputhje me standardet e botës së qytetëruar. Në vitin 2005 u hodh një hap i madh para, por ndërkombëtarët patën rezerva edhe për këto zgjedhje. Tani kemi para një javë, deri te çasti kur do të ndalojmë para kutisë së votimit dhe do të përdorim votën tonë për rinovimin e pushtetit vendor. Ndonëse pati një luftë nervash midis dy kampeve për datën e zgjedhjeve dhe disa çështje të tjera që kishin të bënin me to, më në fund fushata filloi dhe gjatë këtyre ditëve kandidatët dhe koalicionet partiake kanë shpallur platformat e tyre të qeverisjes vendore. Fushata në përgjithësi ka kaluar e qetë, pa incidente të rënda. Bie në sy e folura aktoreske e kandidatëve për kryetarë. Ata në përgjithësi recitojnë shprehjet streeotype që i kanë mësuar ose në shkollën e partisë, ose në trainime OJQ-sh. Mungon flora dhe fauna e të folurit të qytetarëve, ose artikulimi i problemeve të tyre. Kandidatët tanë rrallë përdorin fjalë të tilla si pluhur, baltë, errësirë, ujë i ndotur, shkollë, dije, teatër, libër, spektakël. Sidoqoftë folësit kanë respektuar etikën, por krahas varfërisë së përgjithshme, ndihet varfëria e ideve. Kandidatët mbeten në udhëkryq, ku rrugët e zgjedhjes së problemeve kryesore të qytetit, komunës, ose nuk njihen, ose nuk qartësohen. Në takime ka patur, në përgjithësi, monolog të kandidatëve. Kanë munguar diskutimet frytdhënëse, ka munguar dialogu për një qeverisje vendore afër qytetarëve. Bie në sy, sidomos në qytet, ndarja, parcelizimi partiak në takimet me kandidatët respektive. Me përjashtim të lagjes Kala, ku banorët kanë marrë pjesë në takimet e kandidatëve pa paragjykim, tubimet e tjera kanë qënë një ngjyrëshe. Kjo tregon se ndarja politike, edhe për zgjedhjet administrative, është qartësisht e dallueshme. Në fakt, ngjyrimi politik i zgjedhjeve për qeverisjen vendore e politizon tej mase votën e qytetarëve.



9 shkurt 2007. Kandidatët për kryetar bashkie zotërinjtë Hoxha dhe Nasufi në takimin me shoqatat e invalidëve

Dita e 18 shkurtit po afron. Qytetarët e kanë marrë ftesën për të shkuar në votime. Koalicionet dhe kandidatët e tyre po zhvillojnë takimet përfundimtare me zgjedhësit. Është një javë në qendër të vëmendjes së ndërkombëtarëve, të cilët nëpërmjet institucioneve të tyre po vëzhgojnë me vëmendje maksimale procesin zgjedhor. Mosrespektimi i ligjit, mungesa e korrektesës së komisionerëve gjatë procesit do të jenë me pasoja për fatin e këtyre zgjedhjeve. Nëse nuk plotësohen standardet e njohura, sërish do të jemi në hartën e vendeve afrikane, ose të botës së tretë, vende që ende nuk kanë zhvilluar zgjedhje të lira. Një vend që nuk zhvillon zgjedhje të lira

dhe të ndershme, nuk mund të ketë një qeveri të drejtë dhe të ndershme. Është në dorën e qytetarëve që të respektojnë ligjin dhe kodin zgjedhor, është në dorën e partive të respektojnë rregullat e lojës për të patur një rezultat të pranuar nga të gjithë, një qeverisje legjitime. Në këto raste barra më e rëndë bie mbi njerëzit e përgjegjshëm, që, për fat, nuk mungojnë as në qytet, as në fshat, as brenda koalicionit të majtë, as brenda koalicionit të djathtë. Në analizën e fundit standardet janë më të rëndësishëm se rezultatet.

Y. Hima

## Jon Impex

AGJENSI TRANSPORTI UDHËTARËSH

Bileta autobusi për Greqi (Janinë-  
Rio- Athinë)

Bileta trageti për Itali

Bileta avioni për Itali

**19 EURO** (Pa taksa)

Tel. 032 31 565

Cel: 068 22 63 650

Lagja: "22 Tetori" pranë Bar "Prince"

## Si mund të mbroni automjetet tuaja?

TEXACO



Goma të ndryshme

ALDOM

Pjesë këmbimi me porosi për automjete të rënda (eskavator, fadrom, traktor, kamion,

Përdorni vajra të cilësisë së lartë

KËTU DO TË GJENI me shumicë dhe pakicë:

Shell



Bateri të cilësisë së lartë

Adresa: Tek Parku i Urës Vajgurore

Administrator: Edison Fitim Beshiri  
Tel: 0682235888; 0692052522

# Bejko sfidon Nasufin

■ Prefekti Bejko fton për debat kryetarin aktual të bashkisë dhe njëherazi kandidat për kryetar bashkie në Berat, z.Nasufi



“Nuk dua që të dal në krahë të kandidatit për kryetar bashkie të forcave të djathta dhe nuk dua që të bëhem pjesë e fushatës midis dy kandidatëve për kryetar bashkie në qytetin e Beratit, atij të grupimit të majtë Fadil Nasufi, dhe Sali Hoxha të grupimit të djathtë, por meqenëse z.Nasufi në mungesë të asaj se çfarë t’u rrëfejë zgjedhësve për atë se ç’ka bërë gjatë mandatit të tij si kryetar bashkie, sulmon nga mëngjesi në darkë qeverinë shqiptare, unë si përfaqësues i qeverisë shqiptare në Berat më duhet që t’i përgjigjem”, - kështu është shprehur në ditën e djeshme prefekti i qarkut të Beratit, z.Roland Bejko, duke e ftuar Nasufin në një debat publik.

Më poshtë prefekti Bejko është shprehur se kam ndjekur me vemendje zhvillimin e fushatës këtu në qarkun e Beratit dhe më ka bërë përshtypje fakti i tendencës që ka fushata elektorale që zhvillohet midis dy kandidatëve në qytetin e Beratit, z.Fadil Nasufi, aktualisht kryetar i bashkisë dhe kandidatit të forcave të djathta Sali Hoxha. Duke vlerësuar qytetarin dhe kulturën 2500 -vjeçare të qytetit të Beratit, Bejko është shprehur i pakënaqur me nivelin ku kërkun ta fusë kandidati Nasufi fushatën për zgjedhjen kryetarin të bashkisë në këtë qytet. “Qyteti i Beratit meriton një fushatë normale të dialogut, një fushatë të debatit alternative, por më vjen keq që po vërehet një nervozizëm në këtë fushatë, ku tensioni politik,

pasiguria, mungesa e qetësisë, agresiviteti, konfedimi i politikave lokale me politikën qendrore, ngatërrimi i qeverisjes lokale me qeverisjen qendrore e bërë enkas nga kandidati socialist Nasufi, mendoj se bëhet me qëllim për të çorientuar qytetaret dhe për të humbur vemendjen nga ato që ai do ta kishte si detyrë elektorale për t’i shpjeguar”, është shprehur Bejko. Më poshtë prefekti Roland Bejko i ka kërkuar kandidatit Nasufi që në qoftë se ai pretendon se ka punuar mirë le t’i tregojë arritjet e tij, pasi një kandidat si Nasufi, që ka qenë për tre vjet në drejtimin e bashkisë në radhë të parë duhet që t’u thotë zgjedhësve atë se çfarë ka bërë gjatë mandatit të tij dhe më pas të premtojë për atë se çfarë do të bëjë. Më poshtë Bejko ka thënë se një kandidat, i cili vjen në fushatë elektorale jo si sfidant, por si një kandidat që ka për detyrë ta mbrojë postin që i është dhënë me votën e qytetarëve ka për detyrë që të bëjë bilancin e punës së tij, të flasë për arritjet që ka kryer gjatë mandatit qeverisës, për ato punë që nuk i ka kryer të japë shkaqet dhe arsyet përse nuk e ka kryer dhe pastaj të shikojë dhe të mbështetet në alternativën e së ardhmes për ato punë që do t’i kryejë. Në këtë kuadër kandidati që do të mbrojë postin natyrisht që

nuk është në pozita komode, por kjo nuk ka arsye që ai të bëhet nervoz dhe agresiv dhe për më tepër të tërheqë vemendjen nga problemet lokale dhe ta perqendrojë atë në problemet kombetare që nuk i përkasin thjesht Beratit. Në këtë sens kandidati i opozitës është më komod, ai është sfidant dhe është i paprovuar në qeverisje ai është provuar në jetën e tij shoqërore, në aktivitetin e tij privat dhe vjen me alternativë duke premtuar se po të marrë besimin e qytetarëve shumë nga këto projekte do t’i realizojë. Këtu nuk ka vend fare për nervozizëm dhe jam i befusuar se si në një qytet si Berati, ku kultura qytetare, kultura demokratike dhe toleranca fetare duhet të shoqërohet edhe me tolerancë demokratike. Jam i befusuar dhe nuk arrij të dalloj cili nga Fadilët do të më ngelet në kujtesë, Fadili përpara fushatës elektorale i qetë dhe miqësor apo Fadili gjatë fushatës elektorale nervoz dhe agresiv dhe për të dalluar Fadilin e vërtetë dhe duke qenë se ai ka atakuar qeverisjen qendrore në të gjitha takimet elektorale dhe duke qenë se unë jam përfaqësuesi i qeverisë në qarkun e Beratit, jam avokati i saj, jam intelektualori i saj, jam përfaqësuesi i drejtpërdrejtë i kryeministrit Berisha dhe duke qenë se Nasufi e ka shumë

qejf që të merret me problemet e arritjeve dhe mos arritjeve e qeverisjes qendrore në këtë një vit e gjysmë që ne qeverisim unë e ftoj zotin Nasufi në një debat televiziv, ku kushtet e debatit le t’i percaktojë ai, por do t’i sugjeroja që të zgjidhte një nga alternativat duke qenë me gazetarë lokal dhe qendror madje do t’i kërkoj që debati të jetë në një mjedis publik, ku të kishte auditor qytetar. Unë do të isha dakort që ai të merrte edhe dy ish-prefektët që kanë qenë përpara meje dhe që janë këtu në Berat, pasi të tjerët nuk ka ku t’i gjejë. Po kështu një variant tjetër do të ishte që z.Nasufi së bashku me stafin e tij qeverisës dhe unë së bashku me stafin tim qeverisës të ballafaqohemi për t’i treguar publikut atë se çfarë kemi bërë ne dhe se çfarë ka bërë ai gjatë kohës që kemi qeverisur së bashku. Ndërsa i kërkon Nasufit që të përballet në debat publik prefekti Bejko është shprehur:

“Unë nuk jam nga ata njerëz që gjërat t’i bëj të gjitha të zeza, mbase Nasufi ka edhe gjëra që mund të mburret, këtë le të na e thotë, por ka gjëra që ai mund të turpërohet e megjithatë unë e ftoj z.Nasufi që të jemi përballë një debati publik dhe më pas le të gjykojë publiku dhe e gjitha kjo kërkoj që të bëhet për shkak se nuk po degjoi asnjëgjë për atë se çfarë ka bërë Nasufi gjatë mandatit të tij trevjeçar përveç kritikave në adresë të punës së qeveris Berisha, ndërkohë që qytetarët nuk shikojnë që të jetë bërë ndonjë punë në dobi të tyre gjatë drejtimit të bashkisë nga Nasufi apo paraardhësit e tij, ndërkohë që qeverisja qendrore ka qenë e partisë së tij. Meqenëse z.Nasufi ndërferon nga problemet lokale në ato qendrore, unë jam gati që të përballem me atë në një debat publik dhe jam gati që të pranojë të gjitha kushtet që ai mund të vendosë”.

Prefekti Bejko përmendi gjithashtu një sërë arritjesh dhe perspektivash të qeverisjes Berisha, duke u ndalur në veçanti në qarkun e Beratit.

Abedin Kaja

## Hibraja, policia të zbatojë vetëm ligjin

Arritja e standarteve në zgjedhjet e 18 shkurtit si kusht për integrimin e Shqipërisë në strukturat euroatlantike, kërkesë kjo e shtruar edhe nga qeveria shqiptare ku para së gjithash edhe nga policia kërkun që të zbatojë ligjin me qëllim arritjen e këtyre standarteve, ka bërë që drejtori i përgjithshëm i policisë së shtetit Bajram Hibraj të zhvillojë një takim me kuadrot dhe efektivat e tjera të drejtorisë së policisë Berat. Në këtë takim ku merrte pjesë edhe shefi i komisarariatit të policisë së Beratit Artan Mehmeti, Hibraj është shprehur se planet, detyrat dhe trajnimi që është zhvilluar me ju do të bëjnë që ju të jeni në gjendje që zgjedhjet e 18 shkurtit të kryhen në kushte sa më normale. Policia e shtetit të zbatojë ligjin dhe të përmirësojë akoma dhe më shumë standartet dhe duke zbatuar ligjin t’i çojë ato edhe më lart sesa standartet e vitit 2005.

Policia e shtetit të përmbushë të gjitha detyrimet me prezencën e saj, me gadishmërinë dhe me përkushtimin që ka ndaj ligjit. Duke iu referuar ngjarjeve të fundit të ndodhura në sigurimin e personelit në gjykata, drejtori Hibraj është shprehur se drejtim tjetër i punës së policisë është edhe çështja e marrjes së masave në sigurimin e aktivitetit normal sipas porosive që kemi dërguar në sistemin gjyqësor pranë gjykatave dhe prokurorive, pasi siç jeni në dijeni edhe të ngjarjeve të ndodhura dhe shqetësimet e trajtuara nga Presidenti i Republikës, si dhe nga drejtues të tjerë si ministri apo



Hibraja në Berat

zv.ministri i brendshëm, detyrat janë të percaktuara në mënyrë të qartë dhe për këtë kërkohet një angazhim dhe një vlerësim maksimal nga të gjithë punonjësit. Më poshtë Hibraj ka shprehur mbështetjen e institucionit që ai drejton si dhe ka inkurajuar këto efektiva në luftën kundër krimit. “Drejtoria e përgjithshme e policisë do të sigurojë në çdo moment mbështetjen dhe do t’i inkurajojë që ju të kryeni të gjitha detyrat me efektivitet në mënyrë që edhe viti 2007 të jetë po aq i suksesshëm si edhe viti 2006 dhe në mjaft tregues të ketë arritje edhe më mëdha. Ky është qëllimi i këtij planifikimi në të gjitha drejtimet e këtij viti. Programi vjetor i drejtorisë së përgjithshme,

programi i akteve normative, plani i veprimeve për goditjen e grupeve kriminale dhe njohja nëpërmjet situatës operative do të bëjnë të mundur që detyrat të planifikohen sa më mirë dhe në të gjitha analizat që do të zhvillohen veçanërisht për goditjen e grupeve kriminale për të cilët do të zhvillohet edhe një analizë fill pas zgjedhjeve në muajin shkurt ku do të percaktohen jo vetëm detyra, por për punonjësit që do të kenë mangësi dhe që nuk do të kenë arritje në punë, do të mbahen qëndrime respektive. Çdo analizë mujore, dymujore, tremujore, gjashtëmujore dhe ajo vjetore do të jetë nominale ku secili do të përballet me treguesit konkret të punës së tij”, ka përfunduar Hibraj.

Abedin Kaja

### Rama dhe Meta shajnë Agim Bregun

Në legjislaturën 2003-2006 në Urën Vajgurore, socialitet ku bënte pjesë dhe Ilir Meta dhe Edvin Rama, prezantuan për kryetar bashkie zotin Agim Bregu, duke i vënë lloj-lloj epitetesh e mbiemrash në rasën sipërore, si të ndershëm, të mirë, të përkushtuar, si njeriu më i gjetur i të majtëve. Më të mirë se ai, zor se gjendej ku rrihte këmba e kalit, ku lindte e ku perëndonte dielli. Po ç’ngjau më 2007? Agimit i futën vëllanë në burg (gjë që ia përmendi dhe daja i Erion Velisë të “Mjafit”, sot kandidat i LSI-së për Urën Vajgurore). Pas fjalës së kandidatit të socialistëve, dajës së Erionit, fjalën e muarën në fillim Ilir Meta dhe pas tij Edvini i Kristaq Rmës. Që të dy sikur e kishin bërë me fjalë, i kërkuan të falur Uranjakëve se për tre vjet kishin patur në krye të bashkisë një njeri që nuk e meritonin, por ata harronin se para tre vjetësh këtë njeri ua prezantuan si gjetjen më të mirë, kur në fakt, ai sipas tyre paska qenë një njeri që e kishte përdorur bashkinë si pronën e çifligun e tij. Është taktikë e vjetër komuniste kjo. Ata e kanë patur dhe e kanë praktikë pune e morali, “hedhin lumin dhe pastaj e shajnë kalin”. Kështu bënë dhe me ish- kryetarin e bashkisë së Urës! Tre vjet më parë që më i miri, më i ndershmi, më i dashuri. Para tre vjetësh ishte vëllai i “trimit” Zarif Bregu, kurse sot, na qenka vëllai i burgaxhiut. Tre vjet më parë na ishte ai që mbante në dorë e në zemër flamurin e partisë, ndërsa sot, na i paska mbetur vetëm huri! Sepse flamurin ja paska dhënë dajës së Erionit të LSI-së. Ky qëndrim sot ndaj ish-të zgjedhurve të dikurshëm, të kujton se ç’kishte thënë Enveri gjatë luftës e për disa vjet me radhë për Beqirin, Petritin, Hiton, Temen, Abdylin e deri te Kadri Hazbiu e Mehmet Shehu. Dhe sot, nuk kanë ndryshuar gjërat në këtë parti. Nuk kanë ndryshuar, sepse nuk ka ndryshuar mentaliteti dhe praktikën komuniste të partisë. Partia po nuk iu binde, të pret kokën. Pas tre vjetësh, nëse dajkua i Erionit, do të fitojë, si ai dhe të tjerë nëpër komuna e bashki, përsëri do të shahen nga udhëheqësit, Rama nuk do ta ketë atë shans, as t’i prezantojë, e as t’i shajë, sepse po përgatitet që tani heqja qafe e Ramës nga udhëheqja e Partisë. Duke etiketuar kandidatët e pavarur, si kandidatët të Nanos, duke i akuzuar këta kandidatët si hajdutë e të paaftë, indirekt këto akuza, Rama dhe Meta ia atribuojnë vetë Fatos Nanos. Ja këta janë socialistët! Ky është morali i tyre!

Bujar Orizaj

# Thirrje e kandidatit Sali Hoxha drejtuar qytetarëve të Beratit

**Vëllezër e motra, qytetarë të Beratit!  
Ju përshëndes me nderim dhe respekt!**

Gjatë këtij muaji kemi biseduar së bashku dhe kemi qartësuar atë çfarë kërkon ju, të nderuar banorë të Beratit, kemi projektuar atë çfarë do të bëjmë së bashku pas datës 18 shkurt, kur ne, me forcën e votës sonë do të nisim për qytetin tonë të shtrenjtë një histori të re. Do t'i kthejmë Beratit ekonominë e tregut, në vend të tregut të vjetërsirave që ka mbytur sot qytetin, sipas idesë së ish-kryetarit socialist. Do t'i kthejmë Beratit rrugët dhe rrugicat e kalldrëmta, në vend të rrugëve dhe rrugicave të përbaltura që ndërtoi ish-kryetari sipas modelit të tij. Do t'i kthejmë Beratit shkëlqimin kulturor, në vend të vatrave të kulturës masive që ndërtauan mu në mes të Beratit ish-kryetarët socialistë të bashkisë. Do t'i kthejmë Beratit muzeun historik, në vend të dhomës së partisë që u ofroi ish-kryetari qytetarëve të qytetit të lashtë të Beratit. Do t'i kthejmë Beratit ujë e pastër të Bogës, në vend të ujit të ndotur që rrodhi dhe rrjedh në rubinetat tona gjatë qeverisjes socialiste. Do t'u japim mundësi mjeshtrave duarartë të Beratit për të ndërtuar bizneset e tyre të gdhendjes së drurit dhe gurit, të punimeve artistike në dru e hekur, në vend të tregëtimit të këpucëve të vjetra të Ura e Goricës. Motra dhe vëllezër të Beratit!

Ne do t'i themi ndal shkatërrimit urbanistik të qytetit emblematik, siç ka ndodhur deri tani nga mungesa e qeverisjes së qytetit. Ne do të bashkojmë qendrën e Beratit me periferitë me



rrugë, drita dhe kanalizime. Qytetarët e ardhur rishtas në periferitë e qytetit ne do t'i integrojmë në jetën, kulturën, përvojën jetësore të qytetarëve më të vjetër të Beratit. Virtytet, energjia e tyre janë pasuri për qytetin. Ne nuk do t'i trajtojmë ata si rezervat votash dhe mjerimi, siç ka bërë qeverisja hipokrite e socialistëve gjatë dy mandateve.

Të nderuar zonja dhe zotërinj!  
Kryetari aktual e ka vënë në gjumë bashkinë e Beratit, e ka vënë në gjumë qytetin e Beratit, e ka shpërdorur energjinë pozitive të këtij qyteti nëpërmjet hipnozës tipike të

fjalëve boshe. Ne do t'i kthejmë gjallërinë bashkisë dhe gjithë qytetit. Qytetarët që nuk duan të flenë do të qëndrojnë në Berat, nuk do të kërkojnë një vend ku punohet. Të rinjtë do të qëndrojnë në qytetin e Beratit. Ne do t'i themi ndal përgjumjes rozë që sjell varfëri, dembelizëm, zbehje të kulturës dhe qytetërimin, siç ndodhi me qeverisjen e socialistëve në Berat gjatë dy mandateve.

Ne do të ndërtojmë institucione demokratike në shërbim të qytetarëve, jo bunkerë të aparatçikëve rozë, siç ka bërë ish-kryetari i bashkisë, i cili për hir të së vërtetës

Nga fushata e kandidatit Sali Hoxha

nuk ka profesion, veç atij të aparatçikut partiak. Ai nuk ka punuar asnjë ditë si mësues. Ai ka qënë thjesht komisar në aksione dhe në komitete partie. Në datën 19 shkurt do të jem unë kryetari i bashkisë së Beratit. Do të jem unë dhe jo familjarët e mi, siç ka ndodhur rëndom gjatë qeverisjes që po lëmë pas.

Motra dhe vëllezër të Beratit!

Merrni pjesë në votimet e datës 18 shkurt dhe më jepni votën. Unë do t'ju kthej bashkinë. Mos harroni! Unë vij për t'ju shërbyer!  
Ju faleminderit!

Sali Hoxha

Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut  
Misioni i Vëzhgimit të zgjedhjeve

## Raport i ndërmjetëm

15 janar-3 shkurt 2007  
Fragment

\*Partitë e shumicës parlamentare dhe ato në opozitë kanë krijuar dy aleanca politike. Partitë në secilën aleancë do të kenë kandidatë të përbashkët për kryetarë bashkie dhe komune, por lista të veçanta kandidatësh për këshillat vendorë.

\*Partitë dhe kandidatët janë duke zhvilluar një fushatë aktive në të gjithë vendin. Deri tani janë vënë re disa probleme lidhur me fushatën, përfshirë sulme verbale, prishje posterash dhe një grindje mes aktivistësh partish, shoqëruar me përdorim armësh. Media po e mbulon gjerësisht fushatën zgjedhore. Partive u është dhënë një minutazh falas, siç parashikohet në ligj dhe në televizionin publik ka pasur debate midis kandidatëve.

\*Përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ende nuk është zgjeruar me dy anëtarë të rinj siç parashikohet në ndryshimet e Kodit Zgjedhor të datës 13 janar. Përveç kësaj, mandati i kryetarit aktual të KQZ-së përfundon më 11 shkurt.

\*Komisionet zgjedhore të Qeverisjes Vendorë (KZQV) u formuan brenda afateve ligjore, por

jo në të gjithë rastet numri i anëtarëve ishte i plotë. Partitë vazhdojnë të shfrytëzojnë gjerësisht të drejtën e tyre për të zëvendësuar anëtarët e KZQV-ve në çdo kohë.

\*KZQV-të kanë regjistruar kandidatët për kryetarë bashkie dhe komune si dhe listat e kandidatëve për këshillat vendorë. Në disa raste regjistrimi i kandidatëve të pavarur duket se është penguar.

\*Listat paraprake të zgjedhësve janë shpallur dhe afishuar për t'u kontrolluar nga publiku. Zgjedhësit kanë kohë deri në 6 shkurt për të verifikuar të dhënat e tyre dhe për të kërkuar korrigjime.

\*Për të vënë në zbatim marrëveshjen e 13 janarit, KQZ-ja ka nxjerrë një udhëzim mbi mënyrën e identifikimit të zgjedhësve që kanë emigruar jashtë vendit, gjë që ka krijuar shqetësim, pasi diskriminon disa zgjedhës dhe zbatim i tij mund të mohojë të drejtën e zgjedhësve për të votuar. Në disa lokalitete, grupet dypalëshe të ngarkuara me identifikim e këtyre shtetasve nuk u formuan, dhe përfaqësues të opozitës lokale nuk u përfshinë në to.

\*Lëshimi i certifikatave të lindjes si një mjet identifikimi për zgjedhësit mbetet një çështje e debatuar. Opozita ka pretenduar se qeveria bën të mundur lëshimin e certifikatave pa patur prova identiteti. Partitë e shumicës parlamentare kanë pretenduar se organet e pushtetit vendor, të kontrolluara prej opozitës, kërkojnë një numër të paarsyeshëm dokumentacioni mbështetës nga shtetas për të cilët kanë dijeni apo besojnë se mbështetësin partinë në pushtet.

\*KQZ-ja ka gjykuar, në një mënyrë profesionale dhe transparente, më shumë se 50 kërkesa ankimore. Në 14 raste KQZ-ja pranoi kërkesën dhe rrëzoi vendimin e KQZV-së. Deri më 1 shkurt ishin paraqitur në Kolegjin Zgjedhor katër apeline kundër vendimeve të KQZ-së.

\*Prezenca e OSBE-së në Tiranë po mbështet KQZ-në në përpjekjet e saj të rëndësishme për të rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi rregullat e reja të lëshimit dhe përdorimit të certifikatave.



## Klima e fushatës

Më 18 janar, partitë e opozitës u bashkuan në një aleancë pesëpartish, të cilat gjithashtu do të prezantojnë kandidatë të përbashkët për kryetarë të bashkive e komunave dhe lista të veçanta partish. Megjithatë, ato nuk mundën të binin dakord mbi rreth 11 njësi të qeverisjes vendore, ku do të konkurojnë me njëra-tjetrën për postet e kryetarëve të komunave.

Kjo strategji ka çuar në krijimin e një farë konflikti të brendshëm brenda të dy aleancave. Në disa raste kryetarë aktualë bashkish apo komunash dhe anëtarë të këshillave vendorë, të cilët nuk janë emëruar prej aleancës ku bëjnë pjesë, kanë vendosur të regjistrohen si kandidatë të pavarur. Këto raste kanë ngritur shqetësim brenda partive, në mënyrë të veçantë brenda PS-së. Aktivistë të partisë ngritën publikisht pyetjen nëse marrëveshjet e negociuara mophonin politikën e PS-së "një anëtar-një votë" për përzgjedhjen e brendshme të kandidatëve. Udhëheqja e PS-së ka kritikuar ata që kanë zgjedhur të kandidojnë si të pavarur, duke vënë në dukje pasojat serioze në rast se kandidimi i tyre rezulton në fitore të kandidatëve të shumicës.

Një tjetër çështje e diskutuar ka qënë grisja e posterave të fushatës prej partive kundërshtarë. Në pak raste, kandidatë të pavarur kanë përvetësuar logot e partnerëve të tyre të mëparshëm dhe i kanë përdorur në fushatën dhe posterat e tyre. Edhe pse shumica e këtyre rateve janë zgjidhur pa incidente, një rast në Gjirokastër çoi në një grindje mes aktivistëve të PS-së dhe PD-së që përfundoi me përdorim armësh dhe një arrestim. PS-ja deklaroi që kandidati i tyre në këtë rreth ngacmohet nga policia për arsye partiake, gjë që mohohet prej policisë.

Disa akuza janë ngritur lidhur me përpjekjet për të ndikuar mbi votën e zgjedhësve, sidomos mes komunitetit rom. Në Pogradec, prefekti i Korçës dhe kandidati për kryetar bashkie i PD-së janë filmuar duke shpërndarë thasë me sheqer dhe dyshekë gjatë një takimi me komunitetin rom. Prefekti as nuk konfirmoi, por as nuk mohoi që këto artikuj ishin shpërndarë gjatë takimit.

## DEKLARATË PËR SHTYP



Kryetari aktual i bashkisë z. Fadil Nasufi

➔ Zoti Sali Hoxha, kandidati i koalicionit të djathtë për kryetar bashkie, në “shëtitjet” e tij elektorale, në lagjet “Barrikadë”, “Çlirim”, “Donika Kastrioti”, “Uznovë” po vazhdon të premtojë e të gënjejë se menjëherë sapo ai të bëhet kryetar i Bashkisë, do të bëjë mrekullira. Do të shtojë rrugët, do t’i japë fund varfërisë, do të ndërtojë pallate për të pastrëhet, do t’i derdhë paratë lumë për njerëzit në nevojë.

Absurditeti i premtimeve dhe gënjeshtrove elektorale të z. Sali Hoxha arrin deri aty sa ai po premtonte se do t’i bëjë të gjithë të pasur.

Dy janë shtyllat kryesore ku po e përqendron vëmendjen koalicioni i djathtë dhe kandidati i saj Sali Hoxha:

Së pari, tek shpifja dhe denigrimi i figurës së z. Fadil Nasufi dhe së dyti tek premtimet dhe gënjeshtrot elektorale.

Shpifjeve të ulta për qëllime politike dhe elektorale të zotit Sali Hoxha, në konferencën për shtyp, përmes dokumentesh ligjore iu përgjigj vetë zoti Fadil Nasufi, kandidat për kryetar bashkie, duke i djegur Sali Hoxhës dhe makinës së shpifjeve të Partisë Demokratike edhe të vetmen kartë elektorale shpifjen, që kujtonin se ishte arma e tyre më e fortë për të denigruar figurën morale, integritetin dhe përkushtimin e zotit Fadil Nasufi në krye të bashkisë së Beratit.

Strategjia e premtimeve boshe e mrekullisë që do të vijë menjëherë kur të vijë në pushtet Sali Hoxha, është utopike dhe e pabesueshme, sepse PD është një forcë politike që ka dëshmuar se pas 3 korrikut ka dështuar duke mos mbajtur premtimet që iu ka bërë shqiptarëve.

Ne po i drejtohem jo vetëm elektoratit të majtë, por edhe atij të djathtë. Mos u gënjeni dhe mos u mashtroni nga “biznesmeni” Sali Hoxha, i cili ju premtonte se do t’ju pasurojë të gjithë brenda natës.

Sali Hoxha nuk është gjysmagjeli i plakës së përrallës që sa herë t’i biesh me shkopin magjik “të pjellë” florinj për njerëzit në nevojë.

Zoti Sali, ka ikur koha e gënjeshtrove dhe e përrallave të Partisë Demokratike!

Po i drejtohem edhe z. Kastriot Dervishi, zëdhënës i fushatës elektorale të PD-së.

Ka ikur koha e mashtrimit dhe askush s’ju beson që ju s’flini gjumë dhe vuani shpirtërisht për hallet e njerëzve, siç deklaruar në konferencën për shtyp.

Mos spekuloni dhe mos kujtoni se me ndonjë shishe birre “Tirana” ju do t’i gënjeni zgjedhësit për të votuar më 18 shkurt.

Kryetari aktual i bashkisë z. Fadil Nasufi që rikandidon për kryetar bashkie dhe stafi i bashkisë që është një staf profesionistësh, pavarësisht nga bindjet e tyre, i ka gati projektet, e ka të qartë vizionin dhe do të vazhdojë t’i bëjë ato realitet dhe për vitet 2007-2011, siç ka punuar me përkushtim edhe gjatë viteve 2003-2006. Zyra e shtypit e fushatës elektorale të kandidatit për kryetar bashkie Fadil Nasufi.

## Gazetës “Lajmëtari”

## Titulli i përgjigjes: “Qyteti i Beratit nën drejtimin e socialistëve ka njohur zhvillim e progres”

Në gazetën “Lajmëtari” të dr. 18.12.2006 është botuar intervista me z. Sali Hoxha, kandidat i koalicionit të djathtë për bashkinë Berat. Ajo që binte në sy në intervistën e z. Sali, ishte mohimi i gjithë punës së bashkisë, ku për hir të së vërtetës punon një staf profesionistësh, i cili pavarësisht nga bindjet partiake, është i përkushtuar dhe i motivuar, për të përmirësuar infrastrukturën e qytetit dhe jetën e qytetarëve.

Ndërsa z. Sali, duke mohuar gjithë arritjet dhe punën e stafit të bashkisë, ka marrë në dorë flamurin e “ndryshimit” të jetës së qytetarëve, duke luajtur kështu rolin e demagogut. Qytetarët beratas e kanë provuar dhe janë zhgënjyer nga qeverisja e PD-së.

Pavarësisht nga hallet e problemet që kanë qytetarët, ata janë të ndërgjegjshëm se bashkia që drejtojnë socialistët, në gjashtë vitet e qeverisjes së tyre ka më shumë hapësirë, më shumë rrugë të asfaltuara, më shumë mjedise shlodhëse e të gjelbëruara dhe s’është ashtu si thotë z. Sali se qyteti i Beratit është problematik.

Padyshim se z. Sali do të bëjë propagandë elektorale dhe do të mohojë arritjet e bashkisë Berat, por ato janë tollumbace të cilat kanë plasur përpara se ato të ngrihen lart në qiellin e fushatës elektorale.

Zoti Sali në intervistën e tij është vënë në pozitë mjerane, duke i mohuar dhe pohuar në të njëjtën kohë arritjet e bashkisë. Plarforma e tij s’është gjë tjetër veçse një gënjeshtër elektorale dhe aspak e mbështetur në realitetin konkret. Duket se z. Sali dhe forca politike që e mbështet nuk ka një vizion të qartë për zhvillimin e qytetit. Në platformën e tij, e cila çdo gjë mund të jetë po platformë jo, shikon një vizion të sipërfaqshëm dhe të përgjithshëm që nuk i shërben qytetit dhe qytetarëve.

Z. Sali akuzon qeverinë vendore se s’ka shtruar asnjë metër katror rrugë dhe s’ka prerë asnjë shirit. Zotit Sali po i bëjmë me dije, se pas 3 korrikut 2005 qeverisja qendrore s’ka dërguar asnjë investim duke dënuar bashkinë e Beratit pse ajo është bashki socialiste dhe pjesa më e madhe e saj është elektorati i majtë.

Pohimi juaj z. Sali është një bumerang që i bie në kokë qeverisjes suaj qendrore. Qytetarët, progresistët kanë sy e vesh, kanë edhe memorje. Ata në qeverisjen e socialistëve preken me dorë ndryshimin dhe jeta e tyre u vendos në parametra normale. Ata e kanë të freskët qeverisjen e piramidave të PD-së e cila e çoi popullin në mjerim e në buzë të greminës. Ishin socialistët e progresistët ata që e shpëtuan popullin shqiptar dhe që i kthyen Shqipërisë dhe Beratit, shpresën, normalitetin për një jetë më të mirë. Në zgjedhjet lokale, sërish qytetarët që mbështesin koalicionin e majtë do të votojnë përsëri për të vazhduar të qeverisin të majtë.

Zyra e Shtypit pranë bashkisë Berat

## ➔ Deklaratë për shtyp

Berat, 03.02.2007

Në emër të koalicionit të majtë “Bashkë për Atdheun” denoncojmë largimet nga puna të 43 punonjësve të Policisë së Shtetit në qytetin e Beratit, vetëm pse qeveria Berisha kërkon të manipulojë zgjedhjet, duke emëruar në Drejtorinë e Policisë njerëz besnikë, të cilët i nevojiten për të vjedhur votat në zgjedhjet e 18 shkurtit 2007. Veprimi i fundit i largimit masiv të 43 punonjësve të drejtorisë së policisë, pa asnjë motiv, s’është gjë tjetër veçse një goditje e rëndë që i bëhet ndërtimit të shtetit ligjor. Për qeverinë dhe z. Berisha largimet e punonjësve të policisë së shtetit kanë qëllim politik.

Qeveria dhe ekstremistët e PD në pushtet kërkojnë që njëherësh të largojnë punonjës me bindje të majta dhe ata t’i zëvendësojnë me militantë besnikë të krahut të djathtë. Kjo strategji e Partisë Demokratike në pushtet i vë kazmën dhe shkatërron profesionalizmin dhe depolitizimin e strukturave të policisë së shtetit.

Largimi i 43 punonjësve të policisë së shtetit Berat, dëshmon se Ministria e Brendshme dhe qeveria s’ka strategji, s’do të ndërtojë shtet ligjor dhe se kjo qeveri është e dështuar.

Në themel të shtetit ligjor është profesionalizmi pa dallime partiake. Largimi, flakja e punonjësve të nderuar të policisë së shtetit, dëshmon për hakmarrjen e hapur të Partisë Demokratike dhe të qeverisë së z. Berisha, e cila po e asfikson çdo ditë jetën e qytetarëve dhe po zhvillon një luftë të hapur politike duke përjashtuar nga radhët e policisë së shtetit njerëz si ju me integritet, me përvojë në punë, me status, me qëllimin e vetëm që të manipulojë zgjedhjet e 18 shkurtit 2007.

PS, si forcë politike progresiste, së bashku me forcat e tjera politike PSD, LSI, PAD, PDS, kanë investuar për të ndërtuar shtetin ligjor, duke i vlerësuar punonjësit nga niveli i tyre profesional dhe përkushtimi i tyre për detyrën.

Ky vlerësim ka qenë është dhe do të jetë edhe për punonjësit e rendit, të cilët janë në shërbim të gjithë qytetarëve. Punonjësit e Policisë së shtetit në radhë të parë i binden ligjit dhe vetëm ligjit.

Kjo është motoja që ata duhet t’i shoqërojnë.

## ➔ Deklaratë për shtyp

Berat 06.02.2007

Fushata elektorale e zgjedhjeve të 18 shkurtit 2007 krahas qytetarisë, shpalsjes së programeve elektorale të partive politike, po manifeston edhe sjellje dhe akte ekstreme të militantëve partiake.

Në një shoqëri të lirë dhe demokratike është krejt normale që të “përplasen” ide, programe e alternativa, por është e papranueshme dhe jashtë gjithë frymës demokratike që duam të ndërtojmë të gjithë së bashku që klima elektorale të acarohet deri në sjellje ekstreme të dënueshme nga ligji.

Ne denoncojmë grisjen e posterave të kandidatit për kryetar bashkie, z. Fadil Nasufi në lagjen Çlirim, në të gjitha stacionet e autobusave dhe iu bëjmë thirrje të gjitha forcave politike që të distancohen nga sjellje të tilla primitive.

Partia Socialiste dhe të gjitha forcat politike të koalicionit të majtë “Bashkë për të Ardhmen” po zhvillojnë një fushatë të moderuar, qytetare, duke shpalosur alternativat e tyre dhe duke i bërë thirrje elektoratit të marrë pjesë masivisht në zgjedhjet e 18 shkurtit 2007 dhe të votojnë programin dhe kandidatit më të mirë.

Ne po zhvillojmë një fushatë të frymëzuar nga idetë dhe programet dhe ftojme dhe forcat e tjera politike dhe veçanërisht Partinë Demokratike, që të mos inkurajojë ekstremistët dhe militantë fanatikë, të cilët duke grisur posterat e kandidatit për kryetar bashkie të koalicionit të majtë “Bashkë për të Ardhmen”, z. Fadil Nasufi, po dëshmon se ende tek kjo forcë politike mbizotëron fryma dhe ekstremizmi politik.

Partia Socialiste dhe forcat e tjera politike të koalicionit të majtë, distancohen nga të gjithë ekstremistët dhe sjellje të tilla primitive siç është grisja e posterave, pavarësisht se cilës forcë politike i përkasin.

Ne i ftojme të gjitha partitë politike të zhvillojmë së bashku një fushatë të qetë zgjedhore dhe të shkojmë në kutinë e votimit në 18 shkurt 2007 pa acarim të fushatës zgjedhore.

Zyra e shtypit e fushatës elektorale të PS



## Deputeti Taulant Dede: “Jo pazare në kurriz të socialistëve”

*LSI-ja të kërkojë falje për humbjen e  
zgjedhjeve të 3 korrikut 2005*

Në mbështetje të kandidatit të pavarur për kryetar bashkie të Urës Vajgurore, kryetari aktual Agim Bregu, ka zhvilluar një takim me mbështetës të tij. Ai pretendon se ka mbështetjen e të gjithë socialistëve të kësaj bashkie. Deputeti i Elbasanit Taulant Dede në këtë takim është shprehur se vjen në Urë Vajgurore jo vetëm si deputet i PS-së, por edhe si beratas, sepse ai është djali i prof. Bedri Dede, i cili është nga Bistrovica e Beratit. Në takimin e zhvilluar rreth orës 11:00, në kinemanë e qytetit, krahas pjesëmarrësve, mbështetës të kandidatit Bregu, merrnin pjesë edhe sekretari zonal i PS-së, dhe njëherazi sekretar i këshillit të bashkisë të Urës Vajgurore, Lefter Doko, Kryetari i LANÇ-it, Kristaq Gjata, Kryetarja e forumit të gruas socialiste etj. Takimin e hapi sekretari zonal i PS-së, të Urës Vajgurore Lefter Doko, i cili, pasi përshëndet pjesëmarrësit në takim falenderoi deputetin Taulant Dede për mbështetjen që ai i jep sipas tij kandidatit të vetëm të të majtës në Urën Vajgurore Agim Bregu. Në këtë takim kryetari i veteranëve të LANÇ-it, Kristaq Gjata tha se “në zgjedhjet e 18 shkurtit qytetarët e Urës Vajgurore do të votojnë për tre kandidatë për kryetar bashkie në Urën Vajgurore. Njëri është kandidati i PD-së, Thoma Rumniçi, tjetri është kandidati i guroreve të Pëllumb Salillarit, Syrja Ormënaj, i cili po shkatërron qytetin dhe tjetri është kandidati socialist që ka mbështetjen e të gjithë të majtës në Urën Vajgurore Agim Bregu. “Unë ju bëj thirrje të gjithë socialistëve të ndershem që të votojmë Agim Bregun”, - është shprehur Gjata. Më pas shumë prej të pranishmëve i drejtuan pyetje deputetit T. Dede ku i kërkonin atij se përse u shkel përzgjedhja nëpërmjet parimit “një anëtar një votë”. Pas diskutimit të të pranishmëve fjalën e mori deputeti Taulant Dede, i cili tha se ju ftoj së pari të duartrokasim për PS-në,

sepse në këto zgjedhje fitorja e PS-së, është fitore e të majtës, mbrojtja e PS-së, është detyrë atdhetare. Unë dua të falenderoj së pari mikun tim dhe birin tuaj, birin e Urës Vajgurore, Agim Bregun që më ftoi të marr pjesë në këtë takim entuziast dhe dua të pohoj se ndihem shumë i nderuar të jem në këtë bastion të PS-së, ku ndodhet dhe një pjesë e origjinës time. Duke dëgjuar xha Kristaqin (Kristaq Gjata, kryetari i veteranëve të LANÇ-it, Ura Vajgurore), duke parë ata fëmijë atje që tundin flamurin kombëtar dhe flamurin e PS-së, m'u kujtua edhe një herë se një nga vlerat më të rëndësishme që kam mbrojtur në këto 17 vjet të tranzicionit PS, ka qenë pikërisht lufta Nacional Çlirimtare pjesë e të cilës kanë qenë edhe ata. Debatikasit, fëmijët e vegjël në kohën e luftës një pjesë e të cilëve janë edhe veterane sot dhe që kanë përvjetorin e tyre sot në 10 shkurt ndaj të duartrokasim për veteranët e luftës antifashiste-nacionalçlirimtare.

Duke folur për marrëveshjen e PS-së, me aletatët e majtë deputeti Taulant Dede është shprehur se në këtë marrëveshje janë bërë edhe gabime të cilat duhet të korrigjohen. “Unë i dëgjova me shumë vëmendje diskutimet, prononcimet dhe pyetjet tuaja. Këtu u bënë disa pyetje që lidhen edhe me zbatimin e asaj që quhet marrëveshja e koalicionit të majtë për zgjedhjet e 18 shkurtit, dhe jam këtu për të pohuar që asnjë nga deputetët e PS-së, nuk mund të jetë, nuk ka qenë dhe nuk do të jetë kurrësi kundër kësaj marrëveshjeje, përkundrazi ne e kemi vlerësuar gjithmonë se bashkimi i të majtës ishte një domosdoshmëri, por të gjithë duhet të jemi të qartë dhe duhet të kuptojmë që në këtë marrëveshje ka pasur edhe gabime dhe pikërisht angazhimi ynë si antarë të PS-së, ka qenë që në këtë fushatë elektorale aty ku janë bërë gabime në zbatimin e kësaj marrëveshjeje ne t'i korrigjojmë, sepse në radhë të parë ne na intereson fitorja e PS-së, madje nga ky takim do t'i thosha dhe një kolegu tim të LSI-së, Pëllumb Xhufi që këto ditë i ka

quajtur disa deputet socialist si çifligar, unë do ti përgjigjesha, i nderuar koleg, merru më mirë me historinë aty ku ke profesionin tënd dhe lërja politikën atyre socialistëve që kanë 17 vjet që derdhin djersë dhe mund për PS-në, për elektoratin e majtë. Unë dua të sqaroj të gjithë socialistët e Urës Vajgurore se nuk ka pasur asnjë vendim të kryesisë së PS-së, asnjë vendim të asamblesë kombëtare të PS-së, që të hiqte emrin e Agim Bregut, i cili fitoi me parimin shumë të rëndësishëm “një anëtar, një votë”, ta hiqte nga lista e kandidimit dhe të vendoste një njeri pa identitet si kandidat të koalicionit të majtë, madje mund t'ju them që është shkelur edhe një vendim i PS-së, sipas të cilit në zonat ku kishin fituar kandidatët për deputet të PS-së, në korrik të 2005, këto zona nuk do t'u jepeshin aleatëve të koalicionit me përjashtim të ndonjë rasti kur për dhënien e këtyre zonave do të ishte dakort edhe deputeti i zonës dhe me sa di unë nga dita e parë dhe deri më 18 shkurt deputeti juaj i nderuar Luan Memushi mbështet kandidatin socialist Agim Bregun. E rëndësishme për ne socialistet është që në këto zgjedhje të fitojë PS-ja, sepse vetëm fitorja e PS-së, e ekuilibron humbjen e 3 korrikut”. Si shkak për humbjen e zgjedhjeve parlamentare të 3 korrikut 2005, deputeti Dedja ka quajtur LSI-në, që sipas tij përpara se ti bashkangjitet PSSH-së, duhet që të kërkojë falje për këtë humbje të të majtës dhe që sollë në pushtet Berishën. “Ne e dimë shumë mirë se cilët ishin ata që kontribuan në humbjen e PS-së, në 3 korrik dhe që sot na janë bashkuar ne dhe ende nuk i kanë kërkuar falje elektoratit të majtë pse sollën në pushtet përsëri Sali Berishën”. Duke i'u përgjigjur pyetjes së njërit prej të pranishmëve në sallë deputeti Dede tha se “ju pyetët pse u ndryshua kandidatura e Agim

Bregut?

-Unë me këtë që po shoh në këtë sallë po kuptoj që kandidatura e Agim Bregut nuk mund të ndryshohet, sepse ai ka mbështetjen e socialistëve dhe të majtëve në të gjithë Urën Vajgurore, pikërisht për këtë arsye unë ju pohoj se Agim Bregu është kandidati real i PS-së, që doli nga mekanizmi shumëdemokratik “një antarë, një votë”, që ne e sanksionuam edhe më parë në dy kongreset e fundit të PS-së. Në fund të fjalës së tij Dede tha “Unë do t'ju ftoja të vlerësonit kontributin 6- vjeçar në drejtimin e bashkisë së Urës Vajgurore të Agim Bregut si djali juaj, si vëllai juaj, si njeriu që ka kontribuar kaq shumë për këtë komunitet, ta votoni atë si njeriun e punës dhe të mos votoni vetëm Agim Bregun, por të votoni edhe listën e këshilltarëve të PS-së, sepse ai që të kontribojë edhe për katër vitet e ardhshme në të mirë të komunitetit të Urës Vajgurore ka nevojë që të ketë dhe shumicën socialiste në këshillin e bashkisë. Unë do t'ju ftoja të mos votoni kandidatin e guroreve, të cilat çdo ditë dëmtojnë shëndetin tuaj dhe mbi të gjitha dëmtojnë shëndetin e fëmijëve tuaj që janë e ardhmja e këtij komuniteti. Unë do t'i uroja nga ky podium fushatë të mbarë PS-së, jo vetëm në Urën Vajgurore por në të gjithë Shqipërinë, unë do t'uroja fushatë të mbarë socialistit Agim Bregu, unë do t'uroja fitore socialistëve të Urës Vajgurore më 18 shkurt, sepse ju, por edhe socialistët e Patosit apo të ndonjë bashkie apo komune tjetër bastione të PS-së, duhet t'i thoni mjaft pazareve që janë bërë në kurriz të votës së socialistëve. Midis Berishës dhe guroreve ju duhet të zgjidhni Agim Bregun, kandidatin e PS-së”- ka përfunduar deputeti Taulant Dede.

Abidin Kaja

### Kryetari zonal i PS-së, së Ura Vajgurore sheh ëndrra me armiq

*Përgjigje kryetarit zonal të PS-së, Ura Vajgurore, z. Petraq Tole*

Kryetari zonal i PS-së në Urën Vajgurore, z. Petraq Tole në një takim me veteranët në këtë qytet zhvilluan me kandidatit për kryetar bashkie të koalicionit të majtë Syrja Ormënaj, midis të tjerash është shprehur se kandidatët e pavarur kanë gjetur strehë në gazetën “TemA”. Ai shtron pyetjen se kush fshihet pas kësaj gazete? Në përgjigje të kësaj pyetjeje unë si gazetar i gazetës “TemA” për qarkun e Beratit, dua t'i them kryetarit zonal të PS-së në Urën Vajgurore se pas gazetës “TemA”, fshihet, profesionalizmi dhe pasqyrimi sa më drejtë dhe në mënyrë të paanshme i asaj se çfarë ndodh në realitetin shqiptar dhe në politikën shqiptare. Duke zbritur në terrenin konkret pra, në pasqyrimin e fushatës së partive politike në qarkun e Beratit dhe konkretisht në Urën Vajgurore dua t'i them shokut Tole se edhe në këtë qytet janë pasqyruar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha takimet dhe zhvillimet politike në këtë qytet. Meraku i shokut Petraq Tole me sa duket është një intervistë e kandidatit të pavarur për kryetar bashkie, dhe njëherazi kryetar i bashkisë së Urës Vajgurore Agim Bregu, i cili në këtë detyrë përfaqëson partinë e shokut Tole. Në intervistën e datës 6 shkurt të dhënë nga kandidati Bregu, për të qenë sa më të paanshëm dhe duke mos u përfshir në garën midis kandidatëve që garojnë për kryetar bashkie në Urën Vajgurore, në hyrje të kësaj interviste nuk është bërë koment për atë se çfarë thotë i intervistuari, por është kaluar direkt në pyetje-përgjigje. Po kështu një javë më parë një intervistë e tillë i është kërkuar edhe kandidatit tjetër të grupimit të majtë Syrja Ormënaj, i cili është shprehur se do ta japë këtë intervistë në ditët në vijim. Për ta qetësuar kryetarin zonal të PS-së, unë do t'i kujtoj takimin e krerëve të majtë Edi Rama dhe Ilir Meta zhvilluar në datë 4 shkurt me antarë dhe simpatizant të PS-së, në Urën Vajgurore, ku ndryshe nga gazetata e tjera të shtypit qendror gazeta “TemA”, dhe ajo lokale “Lajmëtari” e kanë pasqyruar të plotë fjalën e dy liderëve të së majtës Rama dhe Meta. Atëherë me të drejtë lind pyetia se kush fshihet pas gazeta “TemA”?

Kjo përgjigje vlen vetëm për shokun Tole, pasi lexuesit e gazetës “TemA”, e dijnë. Pas kësaj gazete fshihet vetë profesionalizmi dhe e vërteta. Unë do t'i thoj shokut Tole se gazeta “TemA” është një ndër gazetata më prestigjioze në vend kjo për arsye se në këtë gazetë për më shumë se një vit shkruajnë editorialistët dhe analistët më të mirë të vendit Andi Bejtja, Blendi Fevziu, Armando Shkullaku, Baton Haxhiu etj. Demokracia është shumëllojshmeri vlerash. Ajo është prezantim dhe konkurim i këtyre vlerave dhe kjo e bën edhe më të bukur demokracinë. Nëqoftëse Tole nuk është mësuar me këtë sistem vlerash duhet të mësohet dhe krizën në partinë e tij mos ta kërkojë te gazeta “TemA”. I rrraskapitur nga betejat politike brenda PS-së, së Urës Vajgurore, shoku Tole shikon ëndrra me armiq dhe gogola, të cilët asnjëherë nuk ka për t'i gjetur te gazeta “TemA”. Nëqoftëse ai ka kurajon le të pyesë deputetin socialist të Urës Vajgurore z. Luan Memushi se kush fshihet pas tij. Z. Memushi e ka mbështetur dhe vazhdon të mbështesë hapur kandidatin e pavarur për kryetar bashkie në Urën Vajgurore, Agim Bregu. Gazeta “TemA”, ashtu si deri tani do të pasqyrojë në mënyrë të paanshme të vërtetën dhe është e hapur për të gjithë garuesit, qofshin këta përfaqësues të partive politike apo kandidatë të pavarur.

Abidin KAJA

## Java e Madhe

► Agim MEHQEMEJA

Pas Javës së Madhe vijnë Pashkët e Mëdha.

Po këto pashkë zgjedhesh kujt do t'i buzëqeshin?

Të djathtë thonë se do t'i gëzojmë ne.

Të majtë thonë se fitorja është jona, se edhe elektoratin e kemi të majtë.

Po t'i hedhin një vështrim fushatës që përgatiti këto zgjedhje, do të vërejmë se lufta për të siguruar fitoren nuk qe e lehtë dhe as e qetë. Në mjaft raste mungoi etika e sjelljes. U kalua në ofendime. Pati edhe grisje posterash të kandidatit të djathtë. Pati edhe akuza ndaj kandidatit të majtë...

Të djathtë, duke qenë për gjashtë vjet në opozitë e kanë patur të lehtë ta ndërtonin luftën mbi gabimet e dukshme të pozitës që kërkon të mbetet sërish në pozitë.

Dhe ka patur të drejtë që të mbështetej mbi këto themele të ngritura dhe të pangritura, se qeveria vendore që ndodhet në pushtet deri më 18 shkurt, veç punëve që ka bërë, ka patur edhe dështime, ka patur edhe shumë premtime të pambajtura. Megjithëse ka patur për tetë vjet pushtetin e saj qendror që duhej t'i jepte mbështetje për t'i vënë në jetë premtimet e dhëna para elektoratit.

Po ja që nuk ka ndodhur kështu. Se ky pushtet i ka derdhur fondet vetëm në prag fushate dhe nga puna për t'u dukur kanë rrjedhur edhe paratë sa i ka marrë lumi.

Le të përmendim vetëm një rast, dështimin e pushtetit vendor në tregun e nisur në lagjen Çelepias, i cili sot ka mbetur një gërmadhë, mbasi ky pushtet nuk zgjidhi problemin me pronarët e truallit, por nxitoi të hidhte themelet dhe këto themele mbetën themele duke marrë edhe miliona me vete.

Dhe pushtetarët që duan ta mbajnë këtë pushtet sërish, e kërkojnë mosrealizimin e premtimeve të tyre jo te qeverisja e tyre 8-vjeçare, por te qeverisja e sotme e të djathtëve. Te mungesa e dritave duke e quajtur me patëdrejtë këtë qeveri si qeveri të errësirës, duke harruar se edhe në kohën e tyre ne kemi mbetur pa drita deri edhe në 10 orë në ditë. Prandaj e nisëm edhe në këtë fushatë duke premtuar sërish ato që lanë pa realizuar në mandatin e tyre, edhe pse i kishin mundësitë t'i bënin realitet, por që ose nuk ia dëgjuan fjalën, ose nuk deshën, se i gjykojnë qytetarët e këtij qyteti të lashtë sot të ri, të majtë dhe se këta nuk kanë për të shprehur pakënaqësi ndaj tyre, nuk kanë për ta humbur votën duke ia dhënë kundërshtarit.

Kurse të djathtë i mbështesin premtimet e tyre në përkrahjen e qeverisë së tyre, që po i jep shenjat se çdo gjë ka për të shkuar sipas parashikimeve. Ja, së shpejti fillon ndërtimi i urës së madhe poshtë digës, që do të shërbejë si një arterie kryesore që do të lehtësojë trafikun dhe do të sigurojë më pas lidhjen e Beratit me Jugun. Ka për të nisur puna për zgjerimin e rrugëve Berat-Lushnjë dhe Berat-Fier si edhe rruga Kuçovë-Belsh për të siguruar lidhjen e shkurtër me Tiranën dhe Elbasanin. Kandidati i djathtë në programin e tij ka menduar për shtrimin e rrugëve të brendshme të lagjeve duke dalë nga korniza e deritanishme që ka mbetur vetëm në aksin kryesor kombinat-Uznovë.

Qytetarët janë joshur nga të dy palët. I mbetet atij të gjykojë dhe të besojë se cili kandidat është më i besueshëm.

Le të presim fundin e kësaj Jave të Madhe për t'u shtruar në sofrën e Pashkës së Madhe!



■ Qerim HYSENBEGASI

Në shkrimin tuaj lexojmë: "Z. Sali Hoxha, bën fushatë në mjegull pa u njohur me zonat dhe banorët."

Z. Sali Hoxha është denbabaden qytetar beratas, s'ka si të mos njohë zonat, lagjet dhe banorët e tyre. Paradok elektoral.

Vazhdohet: "Janë 50 projekte që presin financim nga qeveria Berisha."

Aferim për 18-20 muaj keni përpiluar, apo projektuar 50 projekte që presin financim nga qeveria Berisha. Sa projekte të tilla keni në dosjet tuaja të përgjumura për 6 vjet qeverisje?! Të nderuar zotërinj që keni pasur gurin dhe arrën në dorë, ç'këni bërë që tani ankoheni për qeverinë Berisha?!

Më tej vazhdoni: "Z. Sali Hoxha dhe stafi i tij, amplifikojnë shpifjet e tyre për të denigruar figurën e z. Nasufi duke përdorur fjalorin e rrugës".

S'më rezultojnë kështu.

Z. Sali dhe stafi i tij i nderuar mbase s'kanë mundur të evidentojnë, të gjitha ato që kanë parë dhe dëgjuar nga banorët e lagjeve, ku kanë shkuar. Ju shtoni se z. Sali dhe stafi i tij, përdorin fjalorin e rrugës. Kini ngatërruar adresë. As zoti Sali, as një nga stafi i tij s'janë ashtu si ju duken ju, të rrugës. Kam marrë pjesë në disa takime të tij me banorët e lagjeve, por s'kam dëgjuar fjalë të tilla. Si duket është jehona e imagjinatës suaj të sëmurë që ju ngacmon timpanin e veshit. Një pjesë e mirë nga ju, s'besojnë as vetë. Ju flisni për zotin Sali me shumë vonesë. Ç'këni bërë ju dhe qeveria juaj për 8 vjet me radhë, apo tani ai kërkon kreun e bashkisë? Me që s'këni ç'thoni, kërkonin "qimen në vezë", shkruani se z. Sali s'ka ngjitur ndonjëherë shkallët e bashkisë, për t'u njohur me projektet e saj. E drejta është që s'e kam pyetur, por ma do mendja që do t'i ngjisë mbas 18 shkurtit, kur të jetë ai në kreun e saj, sigurisht po e votuan.

Ju s'doni të pranoni që demokracia është rrotacion. Kur shkruani që "shpifjet tuaja do të dështojnë me turp, ne nuk shpifim, por konstatojmë. Konstatimet s'kanë pse dështojnë me turp.

Nga 2 vezë që përplasen, njëra do të thyhet, por e thyera s'është e mbuluar nga turpi... Pra, njëra do të jetë e pozitës, tjetra e opozitës. Fitoftë më e forta!

Këtë shkrim e titullova: "Shumë projekte për fare pak gjë"

Në vend të replikës

# Shumë projekte për fare pak gjë

"Lexojmë shumë, shohim pak, fare pak për të mos thënë hiç:

Ura e Goricës, monument kulture, rënkon nën blloqet e betonit. A mendoni se kjo është mënyra më e mirë për ta mbrojtur atë? Zoti dhe bashkia e dinë.

Nxiu nga errësira Kalaja, lagjja muzeale, krenaria e Beratit.

Nuk e urojmë si ju, u bë diçka, por ajo që u bë u zhduk si vesa para diellit. Qau ajo për një shërbim urban, autobus, mikrobus, apo furgon, por... tingujt e kabanës s'arrijnë në veshët e bashkisë.

Sheshi qendror para K. Qarkut dhe prefekturës i shëmbëllojnë lakrorit me petë të grisura.

Po qe se hyn në brendësi të lagjeve puna ndryshon. Të shohin sytë llahtar, gropa e pellgje uji që u ngajnë "minipishinave", ujëra të bardha e të zeza, trazuar si për t'i thënë njëri-tjetrit: "Tani mos u shqetësoni se jemi bashkë si vëllai me vëllanë." Togjet e plehrave u shëmbëllojnë qipive të kashtës. Rrugë të nisura e të lëna shkrete, si për të akuzuar qeverinë për mungesë fondesh. Askush s'ta thotë se ku shkuan ato që erdhën. Vetëm s'ka, s'ka fonde!

Sheshet midis pallateve për faqe të zezë. Do të numërojmë pa fund, por më kot. "Trokit në porte të shurdhët". Ndaj dhe shkrimin e titulluam "Shumë projekte thuhet se për asgjë." Qytetari i thjeshtë s'lexon projektet e bashkisë, por sheh dhe prek. Ç'të thotë i varfëri kur rrugët dhe sheshet janë pa ndriçim rrugor?

Lumi Osum e di se ç'heq, mos e pyesni se në vend të tij, do t'ju përgjigjen ujërat e zeza që derdhen në të.

Qytetar i nderuar, voto ose për projektet e bashkisë ose për ato që përjeton!

Mos harroni se të parët thonin:

Po na mashtrove për herë të parë, turpi t'u vulostë në ballë!

Po na mashtrove për herë të dytë, e keqja ne na i zëntë të dy sytë

Zoti na dhëntë mend, zgjedhshim më të mirën!

## Karrige për Bar- Restorante

C  
I  
L  
Ë  
S  
I



tel: 036220295

Shtëpia e Bojërave

# ICRO COATINGS

Bojëra, plastiko,  
hidromat, pigmente etj...

Tel: 37 290. www.icro.it.

Pranë postës



Bujar ORIZAJ

■ Më së fundi dhe kryebashkiaku në detyrë, mori zemër dhe nisi fushatën për të rikërkuar dhe një mandat tjetër për të qenë qytetari numër një i qytetit të Beratit. Në shëtitjet e tija nëpër qytet, ai shoqërohet vetëm nga punonjësit e administratës së bashkisë dhe nga punonjësit e zyrave që ai ka hapur me shumicë në çdo lagje. Megjithatë nëpër kronika, që i përgatitin po vetë, theksojnë se ai bëri takim me banorët e lagjeve, por banorë lagjesh ata quajnë fëmijët që u shkojnë nga pas dhe ndonjë plak a plakë që i shtynë ditët në shtëpi e s' dalin dot as në sokakët e lagjes, se nuk i kalojnë dot pellgjet me ujë që janë hapur para çdo shtëpie.

Kryetari akoma në detyrë kudo që ka shkuar sidomos në lagjet e periferisë, e kanë pritur me këmbët e para. Për çfarë t'u mburret ai banorëve të lagjeve? Për rrugët që i la për ibretalem (për faqe të zezë), për ujërat e zeza që për 6 vjet të socialistëve në detyrë në bashkinë e Beratit muarën dhenë dhe u bënë njësh me ujërat e bardha? Ç't'u thotë, kryetari akoma në detyrë, qytetarëve, ose thjesht banorëve të lagjes "Muratçelepi", për tregun që nuk ua bëri kurrë? Vetëm që në mes të pallateve u ngulën ca tubo hekuri u derdh ca çakull a beton, por kjo u bë për të vjedhur fondin, sepse u harxhua një "thelë", por specialistët e hajdutllëqëve e kanë shënuar një "pelë". Po tregu te fusha e pyllit? Dhe atje u

## Kryetarit në detyrë ia mbyllin dyert kudo që shkon!

hodhën disa makina zhavorr lumi. Dhe ky zhavorr po me të njëjtën taktikë u hodh. Se mos vidhet vetëm te pazaret, vjedhja te ne është bërë e shtëpisë që kur ata morën në dorë bashkinë në vitin 2000 me kryetar Niko Matën, që bëri ç't'i deshi qejfi në Berat dhe për funddimri, nuk i hyri gjemb në këmbë. Nuk i hyri se ai që erdhi, nuk mund të akuzonte ustanë, sepse si ai do të bënte dhe ky. Tërë ato shkelje që i zuri Kontrolli i Lartë i Shtetit, apo kontrollet e financës së prefekturës për shpërdorime, ai që i zuri zyrën nuk i kërkoi kurrë hesap se përse psh. qendra shëndetësore e lagjes "Donika Kastrioti" nuk u la në ambjentet që ishte (në një pallat në katin e parë, e sistemuar në dy dhoma kuzhine, banjo e korridor), që kushtonte për t'u blerë në vitin 2001, 1.6 milionë lekë të rinjtë; ku mund të blihej dhe hyrja tjetër, po për 1.7 milionë lekë të rinj. Të dy së bashku ku do të kishte 4 dhoma, 2 banjo, dy korridore, do të paguhej 3,3 milionë lekë të rinj. Kurse firma që ngriti në mes të natës ish-kryetari me dy punëtorë e me dy lopata e me një kazmë, ndërtaun një kotec, duke e matur nga sipërfaqja e jashtme pa llogarit trashësinë e mureve është 6x6, ku janë brenda për brenda 4 dhoma! Një vrimë banjoje! dhe një pikë korridor 1,5 m e 1,5 m, por 6,5 milionë lekë të vjetër. Ja, as për këtë që duket edhe sot, zëvendësuesi nuk i tha plaç me gojë atij që iku. Shembullin e tij e ndoqën dhe ish-drejtuessit e institucioneve që vareshin nga bashkia, por që bënë të njëjtën kërde dhe si ish-shefi i tyre, u larguan për te hjadutët e mëdhenj në Tiranë. Nuk e dimë nëse kryetari aktual nuk fiton, do të ikë për në metropol apo do të nanurisit në jetën sedentare në Berat, ku realizimi dhe ideja më gjeniale që përsëritet

çdo vit është "kampionati që bëhet për puthjen më të gjatë në Kala më 14 shkurt. Çudia e një dite fushate u realizua pikërisht para tre ditësh kur kandidati i koalicionit qeveritar Sali Hoxha ishte në lagjen "Kushtrim", ndërsa kandidati i opozitës, shkoi deri te sinori, ku para disa vjetësh qe shtruar një segment rruge me asfalt, ndërsa në lagjen "Kushtrim" rrugët janë si në fshat pikërisht deri aty erdhi kryetari aktual, më tutje nuk bënte dot se nuk kishte se ç't'u thoshte banorëve, pikërisht për këtë rrugë që premtoi 3 vjet më parë. Kur, po para 3 vjetësh e pati premtuar dhe paraardhësi i tij që ia ka mbathur për në Tiranë. Dikur, një legjislaturë më parë, një socialsit, jo pa peshë në jetën politike të qytetit, pati shtruar pyetjen në një takim partie me kandidatët e komuanve e minibashkive e bashkive të rrethit të Beratit, i pat thënë atëherë kryetarit në detyrë të bashkisë, atëherë kur ky ishte kryetari i Partisë në Rreth, kështu: "... të mos merreni me hajdutët e vegjël, me ata që vjedhin gjera të vogla, por të merreni me hajdutët e mëdhenj, që për fat të keq, i kemi midis nesh". Dhe pyetja që iu bë atëherë ish-kreut të partisë, që kërkonte karrigen e kryebashkiakut, "ç"do të bëhet me hajdutët që ju kanë përmendur, do t'i denonconi në prokurori? Do t'i largoni nga puna? Dhe a ndodhi kjo? E para, kryebashkiaku u kishte letrat në dorë, ato letra që të çojnë prapa hekurave. As i largoi nga puna, sepse i duheshin për eksperiencën e vyer që kishin. Dhe e treta, u ndërroi vendet, sepse dihet se dhe uji kur rri 40 ditë në një vend qelbet e jo më njeriu që ka vese të liga. Kështu që në bashkinë e Beratit, para tre vjetësh

nuk u bë pastrimi nga hajdutët. Pikërisht për të bërë pastrimin total të institucioneve që gulojnë nga vjedhësit, duhet që në bashki të ketë një njeri që nuk e njeh vjedhjen. Në një takim kryetari aktual tha se qeveria ka bërë pushime nga puna dhe solli si shembull 8 policë të hequr nga shërbimi zjarrfikës. Dhe sikur të jetë e vërtetë nuk ka përse t'u duket ndonjë hata e madhe. Kryetarit duhet t'i kujtohet se në vitin 1997 kur ai drejtonte tok me Flamur Rogun partinë, dhe më vonë e drejtoi i vetëm se Rogu u bë deputet, sa njerëz, baballarë nëna e fëmijë u pushuan nga puna vetëm se ishin të djathtë? Më e keqja djemtë dhe burrat jo vetëm në polici, por kudo u zëvendësuan me terroristë që kishin djegur e vrarë. U zëvendësuan me njerëz pa arsim fare (ka akoma edhe sot nga këta pa arsim në disa vende pune, sepse deftesat fallo të tyre nuk po i kërkon njëri që t'i verifikojë nëpër anizat e shkolalve ku i kanë marrë.) Kryetari aktual bën mirë që të tilla ankesa të mos ketë se të tëra janë simetri me ato që ka bërë ai kur erdhi në fuqi. Me një përjashtim se nga radhët e PD-së nuk ka terroristë e zjarrvënës. Sepse e dinë se ç'kanë bërë socialistët për tetë vjet në qeveri dhe 6 vjet në bashki, sepse nuk kanë besim te ata, që nuk e pritën dhe ia mbyllën derën kandidatit të majtë. Thonë se Ilir Meta e di se ky kandidat do të humbasë, prandaj ia la dhe Edvin Ramës që të akuzojë Ramën për punë të dobët të kuadrove të tij. Pas gjastë vjetësh Beratit do t'i kthehet një djallë nga qyteti për ta drejtuar. Ndj kudo që zoti Sali Hoxha ka qenë për fushatë, burra e gra, pleq e plaka, të rinjë e të reja e kanë përcjellë me fjalët më të ngrohta dhe me urimin: "Ta gëzosh vendin e kryetarit të bashkisë!"

### Në vend të kujtesës

## Problem që s'duhet lënë në harresë

■ Fushata zgjedhore ka arritur kulmet si nga e djathta ashtu dhe nga e majta. Njëri krah bën premtime të përsëritura që gjashtë vjet më parë dhe tjetri krah duke evidentuar ata që janë premtuar dhe nuk janë relizuar. Kuptohet që i dyti si konstatues e ka më të lehtë përballjen dhe ndjehet më komod mes popullit në ballafaqim. Të gjithë beratasit po i ndjekin me qetësi përballjet shumë kush dhe me një kritikizëm të sëmurë. Të gjithë e dimë se fjala të sugjestionon dhe si e tillë ajo ka shumë vlerë për momentin.

Arixheshkat flasin bukur, këndshëm sa të prishin mendjen dhe jo pak veta kanë nxjerrë lekët nga xhepi dhe ua kanë lëshuar në prehër dhe më pas kanë kuptuar se ishin mashtruar; ndaj në këto zgjedhje duhet të jemi të kujdesshëm që të vlerësojmë punën dhe jo fjalët e bukura. Se ku kam lexuar se në Francën e para Napoleonit ishte zgjedhur një kryetar bashkie, i cili për të ndërtaun rrugën e lagjes kishte falë gjysmën e oborrit të tij dhe të tjerët nën shembullin e tij falën nga prona e tyre dhe ajo rrugë paskësh qenë më e bukura e Parisit. Këtë njeri që nuk kishte fjalë, por punë e kishte propozuar vetë populli për kryetar bashkie dhe ai ishte zgjedhur. Kjo rrugë kishte provokuar projektin e madh të Napoleonit për qendrën e Parisit, e cila u rezistoi kohërave.

Dikush më pyeti:

-Ç'mendim ke për kandidatit e djathtë?



Unë e pashë thellë në sy dhe iu përgjigja:

-Është personi më i gjetur i viteve pas nëntëdhjetës, pasi ai aftësinë e tij e tregoi që në vitet e para të demokracisë në detyrat që iu ngarkuan duke i kryer me sukses e pa lënë dyshime. Kryesore është fakti se rrjedh nga një familje pronarësh, përfaqëson qytetarinë beratasë. U mbështet nga inteligjenca e qytetit dhe është specialist i ekonomsë gjë të cilën e kërkon vendi që ai pretendon të zërë.

Mbas përgjigjes time ai më buzëqeshi dhe më vuri dorën në sup me dashamirësi. Nuk di nëse e kishte atë

mendim apo e miratoi nga ajo bisedë. Nga titulli. qëllimi i shkrimit tim është tjetërkund. Nga kandidatët e të dy grupimeve po bëhen shumë premtime dhe po hapen shumë probleme. Mendoj se problemi themelor, i cili do të emërtojë Beratit qytet evropian është puna që duhet bërë në të ardhmen për të kontrolluar ujërat e shiut që vijnë nga kodrat e qytetit duke sjellë në brendësi baltë, gurë e rërë. E gjithë kjo bën qyteti ynë sa herë të bjerë shi të mbushet me baltë, ndërkohë që uji është shkatërrimtari i asfalteve. Kuptohet që kjo gjë duhet bërë nëpërmjet një pune të studiuar mirë dhe për një periudhë afatgjatë. Mendoj që kjo të jetë një prioritet i këshillit bashkiak që do të vijë dhe i kryetarit të saj. Problemi i dytë që do të shtroj është dhe ai i kapakëve të pusetave, të cilat sapo vendosen përsëri hiqen. Unë mendoj se kjo gjë arrihet shumë lehtë: mjafton të jetë angazhimi për të zgjidhur këtë problem që prej vitësh është bërë gangrenë.

Unë nuk di mirë punën e policisë bashkiake, por mendoj se kjo polici mund ta gjejë fare lehtë se kush i grumbullon këto hekurishte dhe një gjobë disa milionëshë do të bënte të mos prekeshin më kapakët e pusetave. Kjo polici mund të kontrollojë edhe dherat dhe mbetjet ndërtime që hidhen në lumë. Puna e kësaj policie shkon deri tek hedhja e një pakete në shëtitore apo e një bishti cigareje. Nëse fillojmë kështu, besoj se qytetaria jonë do të mund të evoluojë drejt civilizimit.

Uroj që për sa shkrova më sipër të kem mirëkuptimin e lexuesve dhe të vlejë në punët e tyre bashkiakëve të ardhshëm.

Luftar Spahiu

## Mesazhi i lotëve



**Donika Kanaçi,**  
nxënëse

Ndodh që të lotosh edhe për vdekjen e një njeriu, që s'ke asnjë lidhje gjaku dhe miqësie.

Në autobusin e linjës Berat- Kuçovë, pranë meje ishin ulur dy burra. Njëri nga ata lexonte gazetën në faqen që shkruhej për vdekjen e aktorit Kadri Roshi.

-Eh Kadri Roshi, sa i madh që ishje!?!...- foli ai dhe sytë iu mbushën me lot.

-Vërtet ishte artist shqiptar i papërsëritshëm, - plotësoi tjetri.

-Ku vjen më Kadri Roshi "Plaku Mere", Kadri Roshi "Ezopi", Kadri i dhjetëra e dhjetëra roleve,- foli më tej qytetari me sy të lotuar. Sigurisht, unë kam dëgjuar shumë për këtë artist të madh të skenës e të filmit shqiptar, por kam parë pak filma që luan ai.

Burri që qante për vdekjen e Kadri Roshit më bëri shumë përshtypje, sepse të lotosh do të thotë të ndjesh dhimbje personale. Dhe, është e vërtetë që arti është subjekti më i fuqishëm argëtues dhe edukues. Pse jo dhe "shtrat loti".

Si adoleshente s'kam ende formim të plotë kulturor që të gjykoj artet e ndryshme dhe ende s'kam provuar të qaj nga forca e artit. Nuk është çudi të japësh dhe një opinion edhe për lotët që derdh njeriu, i ngacmuar nga ndjenja të ndryshme, veçanërisht në letërsi dhe filma. Çdo vesë loti aspak s'duhet marrë si ndjenja më e lehtë, por një mesazh kuptimplotë. Të gjithë jetojmë me halle, stresse dhe lloj-lloj ndjenjash. Për mendimin tim loti është pronë private dhe askush nuk duhet të ndërhyjë për qëllime në vetvete. Kush qan, ka produkt të madh mendimesh e ndjenjash. Askush nuk qan kot. Dhe e ashtuquajtura "lot krokodili" është tepër e veçuar përballë lëndinave me lotë të pastër e kolonive të tëra njerëzore. Loti, vërtetë është i ngrohtë si gjaku, por nuk është i fshehur nën lëkurë. Ai është publik dhe pa ngjyrë, çka kupton se nga buron dhe për çfarë buron. Kam dëgjuar një shprehje që thotë "loti sjell lotin". Dhe kjo është e vërtetë. Vini re një njeri që qan nga një dasmë apo ndjekje familjare. Pas tij lotojnë edhe të tjerë. Kjo tregon se ne e duam njëri-tjetrin, bashkohemi me shqetësimet dhe hallet e shokut apo shoqes, komshiut apo mikut. Është kumanizëm i madh të shoqërosh me lot dikë tjetër. Por loti duhet të ketë edhe kufi, jashtë depresionit dhe sentimenteve të dëmshme shpirtërore. Të lotosh shumë, natyrisht të varfëron shpirtin dhe arsyen. Ka dhe njerëz që përballë dramave të tyre nuk lëshojnë asnjë pikë loti. Kjo nuk do të thotë se ata janë "shpirt kazmë", apo pa ndjenja. Ata duhen konsideruar si njerëz me karakter të fortë dhe ekuilibruar. Nga lotët pa motive të forta duhet të ruhen moshat e reja, veçanërisht femrat. Mesazhet e lotit janë ekuilibruar dhe edukuese kudo. Të dëgjosh një njeri që vajton me lot dhe ligjërime nuk është vetëm respekt, por edhe kulturë apo pavdekësi tradite. Ligjërimit me vajtime dhe lot janë edhe folklor i pastër, por dhe copëza historie. Të dëgjosh plakut e moshuara kur qajnë me ligjerime me të vërtetë të ngjethet mishi. Nuk ka artistë t'i zëvendësojë ato... Në konturet e shpirtit të tyre gjenë ajkën e kulturës popullore të pazëvendësueshme. Shqiptari ka një mënyrë të veçantë të qari me ligjerime që s'e ka askush në botë. Kush nënvlerëson këtë vlerë, nuk ka mend në kokë e "gjak" në shpirt. Loti njerëzor interpretohet në mënyra të ndryshme. Unë dhashë mendimin tim si adoleshente, të tjerët le të shprehin dhe në kënvështrime sociologjike. Dhe si mbyllje po jap këto vargje nga vendlindja ime, Roshniku:

"Ç'po ma derdh lotin, nuse, rrëke- rrëke,  
E ke nga halli, apo je me nge?"

# Kandidatët përballë njerëzve të pamundur

Z. Fadil Nasufi e Sali Hoxha përballë pesë shoqatave me aftësi të kufizuar



Në datën 9.2.2007 në një nga mjediset e pallatit të kulturës "Margarita Tutulani", u zhvillua takimi elektoral me përfaqësuesit e shoqatave me aftësi të kufizuar si shoqata e të verbërve, shoqata e invalidëve, shoqata e paraplegjikëve, shoqata e prindërve nën kujdesin e fëmijëve me probleme, shoqata e shurdhmemecëve. Me ftesë të kësaj konfederate ishin të pranishëm z. Sali Hoxha, kandidat për kryetar bashkie të koalicionit të djathtë dhe z. Fadil Nasufi, kandidat i majtë. Gjithashtu edhe dy përfaqësues të konfederatës kombëtare të kryesuar nga z. Bashkim Seitaj e zonjusha Eglantina Litaj. Zoti Seitaj solli përshëndetjen nga Dr. Pr. Avokat Sinan Tafaj. Ndër të tjera ai theksoi se personat me aftësi të kufizuar kërkojnë më shumë vëmendje nga ana e bashkisë. Ata sot kanë një status dhe duhet ta gëzojnë. Më pas fjalën e mori z. Gëzim Lavdari kryetar i këtij forumi, i cili falenderoi të dy kandidatët që pranuan ftesën. Këtë e tregon edhe pjesëmarrja jonë ndaj jush. Ndër të tjera z. Lavdari theksoi se ne nuk kërkojmë lëshime e keqardhje, por dashuri e respekt, le të fitojë më i miri, ai që sjell progres.

Zonja Liljana Baka lexoi thirrjen që ka lëshuar Konfederata Shqiptare e personave me aftësi të kufizuar drejtuar të gjitha subjekteve politike e kandidatëve për kryetar bashkie si dhe kandidatëve për këshillin bashkiak që në programin e tyre të përfshihen edhe kërkesat e njerëzve me aftësi të kufizuar.

Më pas e mori fjalën z. Fadil Nasufi, i cili pasi mbajti një rezume mbi aktivitetin e bashkisë dhe ndihmën që i ka dhënë këtij komuniteti, theksoi se ka ndihmuar tre shoqata

me zyra dhe ka zgjidhur disa probleme për aq sa e lejon ligji she statusi juaj. Më pas iu përgjigj pyetjeve nga salla, premtoi se do të kujdesej edhe për dy shoqatat që s'kanë zyra dhe do t'u qëndrojë pranë për problemet e tyre. Do t'ju krijoj një shërbim të shpejtë pagese. Së shpejti do të zbatojmë një program për antikapitet nga Qeveria Zvicerane.

Sali Hoxha, kandidati i së djathtës, iu drejtua pjesëmarrësve në sallë: "Të nderuar vëllezër e motra, jemi në prag zgjedhesh. Unë ju falënderoj ju për ftesën. E dëgjova thirrjen tuaj në emër të këtij komuniteti. Ju takon më shumë seç duhet. Ju do ta keni dashurinë dhe respektin e administratës së bashkisë sonë.

Krahas përfitimeve nga statusi që ju gëzoni nga unë do të keni shumë lehtësira që do t'ju lehtësojë sadopak dhimbjen e problemeve shëndetësore.

Unë si biznesmen do të vë në lëvizje disa biznesmenë beratas, që të kontribuojnë sadopak në aktivitetin tuaj kulturor-sportiv, do të ul në 50% tarifat që vendos bashkia, do të kontribuoj për ato shoqata që s'kanë mjedise, do të grupojë në mjedise sa më komode."

Më pas të pranishmit së bashku me të dy kandidatët për kryetar bashkie iu drejtuan Bar "Palma", ku u shtrua një koktej. Edhe këtu bashkëbisedimi i të pranishmëve me të dy kandidatët ishte tepër miqësor.

Fjala jonë e tregon në 18 shkurt.

Le të fitojë më i miri, më organizatori, më progresisti. Votime të mbara të nderuar qytetarë të këtij komuniteti.

Josif Mio

## KURDOHERË VËMENDJE

Jemi në muajin e fundit të dimrit. Zhvillohen nëpër shkolla orë të edukimit fizik. Në fshatra e qytete kanë rënë gripi apo sëmundje të ndryshme të stinës. Në këto kushte, çdo mësues kujdestar dhe ai i edukimit fizik, para se të fillojnë orën e mësimit e në veçanti atë të fizikulturës, pas grumbullimit të fëmijëve duhet që mësuesi të pyesë nxënësit, kush është i sëmurë, kush ka kaluar ndonjë sëmundje tani afër, kush nuk e ndjen veten mirë etj. I veçoni këto nga rreshti dhe i lë të vazhdojnë orën e mësimit me ata që mbeten. Në fund të orës, nxënësit aktiv vishen. Kurse nxënësit që dëgjuan dhe panë lëvizjet, pyeten nga mësuesi, për elementet e veçanta të orës së mësimit. Kështu të dy palët marrin pjesë në orën e mësimit. Prandaj duhet kurdoherë me vëmendje se kemi të bëjmë me shëndetin e fëmijëve.

**Jorgji Bendi**

## “PEGAS 2006-2007”

Vazhdon konkursi poetik “Pegas 2006-2007”. Këtë vit çmimi poetik do të ndahet për të gjithë krijuesit, pa dallim moshe.

I vetmi kriter është numri i

poezive 7 (shtatë) dhe cilësia artistike. Poezitë të sillen në disketë.

Poezitë që kanë cilësinë artistike do të botohen në faqet e gazetës

“Lajmëtari” gjë që do të thotë se janë në konkurim.

Konkursi mbyllet në 31 mars 2007

Lajmëtari

### Poezi nga Fatbardh Hoxha

#### ME MUNDON SHUME

ME MUNDON ME SHUME SE SA MUNDOHET NJE  
ZOG PA KRAHE PER QIELLIN E LARGET,  
ME MUNDON ME SHUME SE SA I CMENDURI  
MUNDOHET TE BINDE NJERIUN NE JETE,  
ME MUNDON ME TEPER SE SA MUNDOHEN  
ATLETET TE FRENOJNE RITMIN E CMENDUR TE  
ZEMRES

NE FINISHIN E TYRE DHE TIMIN NJEKOHESISHT...

ME MUNDON, ME MUND DHE ME DON, PA DITUR  
ARSYEN E MUNDIMIT E TE DASHURISE,  
MARREZIA IME DHE HARBIMI YT NJE LEMSH QE  
S'KA MAGJISTARE TA SHQEPI NE BOTE,  
TI LUTU ME LOT NE SY, BOTES SE QULLUR NE LOT  
E NE VAJ.

DHE MUA KURRE MOS M'U NDAJ...

#### ROSAT E EGRA

Ishin dy rosa te egra  
Gati te ngriheshin ne fluturim  
Per t'i afruar sqep me sqep duhej heshtje  
Per t'i nisur larg mjafton te zgjasje doren  
Dhe ato merrnin qiellin...  
Ti kishe kohe qe j'ua fshije koken  
aty nen bluzen e trashë  
ato, qiellin e çmendur mos ta shihnin.

#### MONOLOGU I MËSUESIT PENSIONIST

Ndiej gumëzhitjen e tyre brenda trurit  
Krahë lakuriqësh që godasin cipën e hollë që  
s'ndien,  
Zëri i tyre fle dhe zgjohet në zgavrat e trurit,  
Fërkon dhe gërryen ca pejza të holla si cipë qepe.  
Cicërimat vijnë nga qiej të tjerë, të panjohur  
Shpendë që përpijnë klorofilën e gjelbert te  
bimës...  
Një rrëmujë e paimagjinueshme, një kantier që  
ulërin,  
Eh h h h...  
Heronj si unë, udhëve flenë tek ecin,  
Pergjumja ime, një kohë e paemër.  
Breza fëmijësh më tërheqin prej xhakete  
Mjegullohet pamja, portreti si para një xhami të  
thyer,  
Unë, çudi, hero i asaj dite, zvarrë pse hiqem  
udhëve!?  
Ndërsa ata kërkojnë e ndjekin shpirtin tim të  
mjerë...

#### PORTA E URDHHERIT

U nisen te gjithë kuajt e politikes  
Me rropullimen e perjeteshme te zinxhireve zvarre,  
Pa pyetur per prangat qe sheshit dukeshin  
Per te lidhur votuesin e marre,  
Pa degjuar as vete gjemimin e hçit  
Qe i ndjek koshet e tyre.

Kanë nje ze e nje hap te hatashem cubash e  
horrash  
Mpleksur me nje lloje koperture blu a roze ,  
Sajojne çorben e peshtire te fjalimeve me menu  
alla evropiançe



Ku djemte çarroshe qeshin nen buze  
Me endrren tek doganat.

#### SHTETI

Përdite kam një qen-shtet pas vetes,  
Më ndjek ngado si hije, më ngjitet pas si rrodhe,  
Më ndjek mua dhe lirinë time.  
Kam mbushur nje plangë të madhe me metafora  
dhimjeje  
Duke vuajtur prej tij  
Si i luajtur mendsh, pushkatuar nga xhindet.  
Ai më therret ngado, më pret udhën,  
Ma bën pis lirinë time,  
Ai është një Haxhi Qamil  
Që i punon qindin Qamiles sime – liri...  
Kombinon shkronjat, rrokjet, fjalët  
Dhe po... më dhunon lirinë time.  
Është shteti mashkull, më i pisti mashkull,  
Mastubon ligje mbi kokën e lirisë sime  
Pa pyetur për telat me gjemba, për Spaçin e  
Burrelin  
Ku mbyllet shpirti im...  
Nuk pyet brutali, ai ha... xhi shpirtin,  
Ai ha dhe hi... qesh e tall lirinë time

#### TI JE ME FAT

Ti je me fat, se te dashurosh nje poet  
do te thote qe vethet brilantë te metaforave  
perdite t'i nderrosh si plaçken me me vlere te  
kesaj bote.  
Perdite te tregu i gabit une do te gjeje te varur  
ndershmerine tendet ,  
e vetmja rrobe qe ka ardhur ne bote te mbuloje te  
marret,  
Ti je me fat, ke lindur ne kete bote ne ditet e  
kiametit .  
Kur bota, vec meje, ndershmerine e mbulon me  
rroba te perdorura.  
Mendoj trupa te tjere tek kane veshur e zhveshur  
cohen tende te holle  
dhe hidhem siper ne morin e trupave te paemer,  
me te gjitha merrem ,vec me ty jo, ti e ke lodhur  
fantazin time,

ti e ke nje emer ne tufen e te marreve te kesaj  
bote,  
tek predikon ndershmeri per ata qe kur te rriten  
te jene viktima te moralit tend absurd.

#### ENGJËJT

Engjëjt jane shokët e mi të vërtetë,  
Gjyshi im nuk ua gjeti dot stofën,  
Im atë nuk ua mësoi dot këngën.

Më erdhën një natë të gjithë së bashku  
Nga mbretëria e tyre e zbrazët,  
Të gjithë veshur me të bardha  
Mbulonin asgjënë që dukej tej e tej.

Erdhën pa ide, me heshtjen magjepsëse të  
pertejme  
Ku fluturimi në atdheun pa tokë e ajër  
Është mrekullia që engjëjt, shokët e mi,  
E ruajnë në kohën pa kohë, për mua.

#### PSHERËTIMË

" Psherëtima të largëta që përshkojnë mishin e  
një bote të shurdhët".

Loius Aragon

Hija ime ndjek parreshtur fjalët e tua,  
Ato nga larg kumbojnë.  
Zëri i harruar, pikon në shpellat e shpirtit,  
Hapësirës boshe i mungon qeliza e gjallë,  
Zëra të largët, bota e shurdhët, dashuria e ngrirë.  
Deri kur do të vazhdojmë kështu  
Duke ëndërruar ledhatimin e një dore te prerë;  
Duke ëndërruar emrin  
Larguar nga ajo që emerton sekondë pas sekonde?  
Psherëtima ngjitet grykë më grykë,  
Gryka është mbuluar nga bora,  
Një dorë e shtërnguar i mbyt tingujt  
Dhe agimi qenka tmerrësisht larg.  
Nëse është vertet ai agim  
I shpirttrave që veç psherëtojnë,  
Në këtë botë të shurdhët fund e krye...

## Lejla Mehqemeja

Rrugën që bëja me të kur zbrisim nga autobusi urban, në Otlak, nuk e ndieja fare.

Përveç të tjerash, prej saj unë kam marrë këshilla që më kanë shërbyer dhe në jetën time familjare. Lejlaja ishte tip analitik, të imponohej me mendimet dhe qëndrimet e saj.

Ajo ishte dhe një meraklie e jashtëzakonshme. Sapuni që lante duart në musllukun e shkollës ishte personal, e mbante në cantë të paketuar me kujdes.

Në çdo hap ajo rrezatonte veç kulturë.

Por ajo që do të më mbetet në kujtesë për tërë jetën, është qëndrimi dinjitoz i saj në një mbledhje speciale ose më mirë ta quaj ogurzezë, apo njollë e zezë në arsimin shqiptar.

Pra, kisha pak kohë që punoja si mësuese, ku u përshtata shumë shpejt me punën falë dhe

Lejlasë së "madhe", por shumë shpejt u zhgënjeva.

Pa na lajmëruar më parë, shumë shpejt u mbledhëm në klasë ku zhvilloheshin mbledhjet (në kabinetin e biologjisë). Sigurisht, kishte dhe të deleguar siç ndodhte në kësi rastesh...

U komunikua pushimi nga puna i disa mësuesve. Njëra (Safuroja) mungonte. Zeneli (Vokopola) mori një pamje dëshpëruese që s'kam për ta harruar kurrë. Sytë sikur iu zmadhuan, habia shprehej në maksimumin e mundshëm. Ishte mësues i shkëlqyer, pse duhej të ndodhte?!

Qetësia është si heshtje varri. E kush do të guxonte të kundërshtonte? Dihej ç' i priste po të ndodhte kjo, por kjo nuk zgjati shumë, sepse u ngrit sokolesha Lejla. Ajo e kundërshtoi



këtë akt të turpshëm. E pushonin për shkak të vëllait të saj...

Shumë krenare, me kokën lart, zërin kumbues midis të tjerave ajo tha: "Unë jam dhe

e bija e babait" (duke folur shkurt për aktivitetin e të atit...)

Me qëndrimin e saj, ajo jo vetëm që nuk iu lut, por dhe denoncoi hapur padrejtësitë që bëheshin në një kohë kur nuk guxoje të flisje, rrezik as me vete për t'iu shprehur kundër...

Vërtet ajo nuk u rikthye, por ajo mbeti në kujtesën time, një shoqe dinjitoze, një mësuese artiste, një femër me feminitet dhe formim të gjithanshëm.

Profesor, të lutem më besoni në sinqeritetin tim. Tek po shkruaj këto rreshta ndiej shumë emocione, të cilat prej shumë kohësh doja t'jua përcillja dhe juve si i afërm i saj.

Lela (siç i thërrsinin) ju donte shumë, ju përmendte shpesh me një kënaqësi që shprehej në sytë e saj të bukur, duke ju përkëdhelur "Gimi"...

Me shumë respekt  
Engjëllushë Dardha,  
zv dr. e shkollës "Zihni Toska"

## Rebeli demokrat

**R**ebeli Kosta Bumbli para e pas çlirimit ka qenë me shpirt dhe me ndjenjë një demokrat i flaktë. Ai ka qenë përparimtar me drejtim e frymë perëndimore, në mbrojtje të pronës private. Prandaj regjimi diktatorial i mëparshëm Kostën e shikonte shtrembër, por ai nuk u përkul asnjëherë. Kosta thotë: "Në vitin 1945 jam arrestuar në mitingun që organizoi Dhespoti Visarion Xhuvani, duke mbajtur flamurin e Ismail bej Vlorës nga Pazari i Misrit deri në Vakëf. Kjo turmë mori formën e demonstratës, për të hapur burgun, por demonstruesit u shtynë e më pas edhe me armë. Kështu që ata u shpërndanë. Këta demonstrues ishin kundër pushtetit popullor, më vonë u arrestuan nga organet e sigurimit të shtetit, Zoica Papalilo, Namik Mehqemeja, Resul Tozhani, Fatmir Dollani, Kosta Bumbli etj. Nga gjyqi, këta u dënuan si armiq të popullit, disa u pushkatuan. Unë (Kosta) vuajta dënimin me burg. Sot gëzoj statusin politik si familje. Kam patur internim pa caktim, më morën dyqanin dhe më çuan me kazmë në ullishte dhe ditët e pazareve më nxorën me autoparlant si borgjez, si njeri që përkrahja pronën private dhe që e zhvilloja atë etj.

Kosta krahas zanatit të tij të kasapit, është edhe një besimtar ortodoks me taban familjar. Ai jo vetëm është i pranishëm për çdo të diel, festave më të rëndësishëm që ka feja ortodokse si psh pashkët e vogla dhe të mëdhatë, të kremteve, festave të emrave të ndryshëm. Por ai është edhe një psalës i mirë, me zërin kumbues përhap fjalët, fjalitë e Krishtit, që dëgjohen në të katër anët e kishës. Kur i vjen radha prapë, për shenjtorët, për pashkët, apo për të kremte të forta, siç është "Java e Madhe", ai parapërgatitet në shtëpi, duke ruajtur kordat e zërit, duke kënduar e vajtuar pjesën që i jepet me muzikë të hershme bizantine. Duke kujtuar këtu imzot Nolin, i cili në moshë relativisht të madh e mbaroi konservatorin për muzikë dhe bëri studim të famshëm për Beethovenin, i një shkalle të lartë muzikore.

Kosta me fanatizëm, ka ruajtur në vende të sigurta dy fotografi të dy viteve 1944, 1945, që janë mbi 60- vjeçare. Këtu shpaloset organizimi dhe drejtimi nga dhespoti Visarion Xhuvani i hedhjes së kryqit, Dita e Ujit të Bekuar. Visarion Xhuvani i asaj kohe dhespot i Kaninës, Vlorës, Beratit e gjithë Myzeqesë me qendër në Berat. Dhespot Visarion Xhuvani për diturinë, mençurinë, për autoqefalinë, për mitingun, u pa me sy të keq nga diktatura e sapo dalë nga lufta me një gjyq të shpejtë e dënuan dhe e pushkatuan.

Shënojmë këtu se kur vdiq myftiu i Beratit, dhespot Visarioni i vuri shpatullat e tij arkivolit dhe e përcollti me nderime për në banesën e fundit, duke mbajtur dhe një fjalim përpara alipsanit, për kontributin e diturinë që kishte myftiu i Beratit (këto të dhëna janë marrë nga një shkrim i Refat Lapardhasë).



Dy psalësit Kosta Bumbli me Raq Tapinë

Pranë psalësit të Kosta Bumbli, në dioqezën tonë, në vçanti në Berat janë një seri e hershme dhe e tanishme, për t'u përmendur si psalës, të tillë kanë qenë e janë: Jani Kolovani, Lip Filipi, Luçi Zaharia (Duhaxhiu), Aneta Bushamaku, Jorgjie Stsasa, Minella Heqimi, Raqi Tapia, i riu Vladimir Rendi, i apasionuar pas psaljeve vullnetarisht.

Këta duhen të përkrahen dhe të shtojnë radhët e psalësve, për të patur një popullim të madh në këtë fushë.

Kosta Bumbli ka psalur në kishat Shën Ilia, Mangalem, Vakëf, në kishat e vjetra të Tiranës, në kishën e Shën Gjergjit në Fier. Tani që nga 12 dhjetori 1990 falet dhe psal në kishën e Shën Spiridhonit në Goricë, e para kishë që u fal pas rënies së diktaturës në Shqipëri nga i fjeturi At ikonom Vangjel Xoxe, në krahun e majtë, pranë trashëgimtarit të Lip Filipit, djali i të cilit quhet Edmond Filipi.

Jorgji Bendi



1943, (Nga e majta në të djathtë)

1. Papa Milto Ilia, Goricë, 2. Papa Mihal Heqimi, Kala, 3. Dhespoti Visarion Xhuvani me dhjakun pas, 4. Papa Theodhor Lako, Vakëf.

1945,  
(Nga e majta në të djathtë)

1. Papa Milto Ilia, Goricë, 2. Papa Sotir Kondi, Mangalem, 3. Dhespoti Visarion Xhuvani, 4. Papa Mihal Heqimi, Kala, 5. Papa Theodhor Lako, Vakëf, 6. Papa Grigor Qyrana, Goricë.

Në të djathtë të zberthyer pallton Kosta

## Portret i kandidatit demokrat Barak Obama

Të shtunën, Senatori Barak Obama ka shpallur zyrtarisht kandidaturën si kandidat i Partisë Demokratike për garën pre-sidenciale të 2008-s.

Përkrahësit e tij besojnë se ai është kandidati më i mirë për të tërhequr votat në një vend me një larmi gjithnjë e më të madhe kulturash.


Në janar Barak Obama deklaroi se po paraqiste kërkesën zyrtare për garën presidenciale, hapi i parë për të hyrë në këtë garë: *“Do të bisedoj me njerëzit në këtë vend, do të dëgjoj e mësoj më shumë për sfidat me të cilat ndeshemi si komb, mundësitë që na dalin përpara dhe rolin që mund të luajë një fushatë presidenciale për të bashkuar vendin”*.

Provoi së pari terrenin dhe më pas vjen shpallja zyrtare e kandidaturës: senatori nga shteti i Ilinoi deklaroi haptazi synimet e tij për të konkuruar për President i Shteteve të Bashkuara. Mesazhi i tij, karizma dhe përvoja vetjake kanë grumbulluar shumë pasues. Anketat tregojnë se ai është një ndër pretendentët kryesorë për të marrë kandidaturën e Partisë Demokratike, si konkurenti demokrat në zgjedhjet e 2008-s.

Obama lindi në Havai, nga një nënë e bardhë dhe një baba kenian. Pas ndarjes së prindërve, Obama, i cili në fëmijëri njihej si Barry, shkoi të jetonte në Indonezi me nënën dhe njerkun. Akmad Solikhin është zëvendës-drejtor i shkollës që ndoqi në fëmijëri Obama: *“Barry ndoqi mësimet këtu nga klasa e tretë deri në klasë të pestë, më pas u kthye në Shtetet e Bashkuara”*.

Samani, i cili si shumë indonezianë prezantohet vetëm me një emër, punonte për njerkun e Obamës për të çuar e marrë djalin nga shkolla: *“Ai ishte djalë shumë i zgjuar, pasi ndiqte dy shkolla njëkohësisht. Ai ndiqte Shkollën Besuki dhe merrte mësimet me korrespondencë nga Shtetet e Bashkuara”*.

Obama u kthye në Havai në moshën 10 vjeçare dhe vlerëson përvojën e tij në fëmijëri për pikëpamjet e tij për kombin dhe



Barak Obama

botën. Barak Obama u zgjodh në Senatën amerikanë në vitin 2004 dhe është aktualisht i vetmi senator amerikan.

Politikani 45-vjeçar ka pasur një ngjitje meteorike në sytë e kombit. Ai ishte thuajse i panjohur kur tërhoqi vëmendjen me fjalimin e tij në Kuvendin e Partisë Demokratike në vitin 2004, ku foli për trashëgiminë e tij afrikane.

*“Prindërit e mi më pagëzuan me një emër afrikan – Barak, apo Bekim, me bindjen se në një Amerikë tolerante nuk ka pengesë për sukses”*.

Shumë analistë mendojnë se mbështetja e fortë publike për Obamën në anketa pasqyron si ndryshimet në

atmosferën politike të vendit, ashtu edhe ndryshimet në gardën politike që ka dalë nga radhët e afrikano-amerikanëve.

Deri kohët e fundit, shumë politikanë afrikano-amerikanë e fillonin karrierën e tyre duke luftuar padrejtësitë racore në lëvizjen për të drejta civile. Por sot, të tjerë si Obama, kanë diploma nga universitete prestigjioze dhe kanë përvojë pune si avokatë dhe ligjvënës. Pavarësisht nga trashëgimia e tij afrikane, anketat tregojnë se Obama mund ta ketë të vështirë të tërheqë votën e afrikano-amerikanëve.

Një anketë e fundit e rrjetit ABC dhe gazetës Washington Post, tregon se ai renditet pas senatorëve demokratë Hillary Rodham Clinton në mbështetjen nga afrikano-amerikanët. Por lobisti Anton Gunn mendon se kampit të Obamës do t'i shtohen shumë votues zezakë me kalimin e kohës:

*“Fakti është se ai po e fillon fushatën për Shtëpinë e Bardhë me një qëndrim më pranë qendrës politike se Jesse James, Shirley Chissom, apo Carol Mosley Braun. Pra ai ndodhet në qendër të spektrit politik nga ku po e fillon fushatën, dhe jo të fillojë thjesht me mbështetjen e afrikano-amerikanëve dhe pastaj të kalojë në qendër. Kjo mendoj se do ta ndihmojë shumë”*.

Të njëjtin mendim ka ligjvënësi Charles Rangel. *“Kandidimi i një afrikano-amerikani sjell një farë krenarie racore, mendoj të ngjashme me atë që kanë ndërjerë irlandezët kur Xhek Kenedi ishte kandidat”*.

Në të kaluarën, kandidatët afrikano-amerikanë në garat presidenciale e shfrytëzonin vëmendjen publike për të theksuar tema të rëndësishme për to, por asnjëherë nuk janë konsideruar si kandidatë me shanse reale. Në rastin e Barak Obamës, thonë analistët, ai jo vetëm që është një kandidat serioz, por fare mirë mund të bëhet President i Shteteve të Bashkuara. //rd//

Jim Bertel 09-02-2007

## Yjet - Me aktorin Nikolas Keixh

lindur me emrin Nicholas Coppola, nipi i regjisorit Francis Ford Coppola, Nicholas e ndryshoi mbiemrin në Cage, pas një karakteri komik librash, Luke Cage, për të shmangur suksesin nën hijen e xhaxhait të tij të famshëm. Nicholas kërkonte ta provonte vetë veten si aktor.

Nicholas është një aktor i dedikuar, që i studion rolet përtej të zakonshmes por kjo nuk e bën të pafavorizuar ndaj mundësive për filma blockbuster. *“Ende e shoh veten si student aktrimi. Kërkojë të mësojë nga çdo rol dhe kështu kam bërë gjithmonë. Eksperienca më ka dhënë shansin të rritem dhe të interpretoj edhe pse ndjehem në një vakum herë pas here”*, thotë aktori.

Në vitin 2002, Nicholas luajti në Windtalkers, një film rreth kontributit të çmuar të indianëve të Amerikës gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai ka patur një varietete rolesh dhe thjesht emri i tij i tërheq shikuesit në kinematë amerikane. Nicholas shihet shpesh si aktor me kapriço dhe rolet e tij të ndryshme e reflektojnë këtë karakteristikë. I pakënaqur të qëndroj thjesht në fushën e aktrimit, Nicholas kapërceu në regji duke adoptuar shpirtin e tij krijues në një pozicion pas kamerave në filmin Sonny. *“Kjo është hera e parë që jam regjisor - mendova se e vetmja gjë që mund të bëja ishte të drejtoja aktorët, të flisja me ta - kështu që në këtë nivel mendoj se ishte gjithashtu ide e mirë për mua të provoja veten në një film të tillë të vogël që është një projekt ku karakteret flasin shumë”*.

Roli më i pëlqyer nga kritikët ishte karakterizimi i një alkoolisti vetvrasës në filmin e vitit 1995 Leaving Las Vegas, një film i pavarur me buxhet të vogël. Nicholas filoi Oskarin si aktori më i mirë. Së bashku me shumë çmime të tjera ka edhe shumë martesa, një nga të cilat ishte ajo me Lisa Marie Presleyn.

Në rolin e tij në filmin Gone in Sixty Seconds në vitin 2000 Nicholas iu bashkua klubit të aktorëve që paguhet 20 milion dollarë për film. Në vitin 2003 ai luajti një rol intrigues të një të fiksuari në filmin Matchstick Men. Ai kërkoi si gjithmonë ta përvetsonte rolin. I vlerësuar nga kritika, diversiteti i këtij aktori të shkëlqyer është me të vërtetë një cilësi e vyer. *“Loja e një karakteri që vuan nga fiksimi ishte i ri për mua dhe doja ta interpretoja me përgjegjësi pasi kam një mik që vuan prej kësaj sëmundje. Doja ta bëja rolin autentik dhe diçka që njerëzit ta kuptonin kur përballen me pacientë të tillë”*. Nicholas Cage është njeriu që ka luajtur shumë personazhe të arrirë dhe dashuria e tij për aktrimin mund të shihet në relaksin dhe kënaqësinë që ndjen ai në sytë e publikut. //rd//

MINI MARKET USHQIMORE BULMETORE ËMBËLTORË

**“ALUSH QERESHNIKU”**

Në dyqanin tonë do të gjeni: 80 lloje verërash.

Të gjitha verërat e Beratit.

Në lagjen “22 Tetori”

Artikuj shkollorë, zyre, fotokopje, shtypshkrime, plastifikuese, punë kompjuteri.

**INTERSIG**

Adresa: Ngjitur me postën qendrore

FERDINAND KADIFEJA

Tel: 32 246

**Shumica Ushqimore**

Tek Axhensia

**Rexhep Arza**

## Kancelarja Merkel kërkon bashkëpunimin e Ruisë për sigurinë globale

Ivana Kuhar 10-02-2007



Kancelarja gjermane Angela Merkel

Kancelarja gjermane Angela Merkel, vendi i së cilës ka kryesinë e radhës të Bashkimit Evropian, i bëri thirrje komunitetit ndërkombëtar që të jetë i bashkuar për të përballuar sfidat globale. Në hapje të një konferencë të nivelit të lartë për sigurinë globale, zonja Merkel i bëri thirrje Ruisë që të bashkohet me përpjekjet për ta bërë botën më të sigurt. Ndërkohë presidenti rus paralajmëroi kundër militarizimit të hapësirës.

Mes masave të rrepta të sigurisë në Munich, Angela Merkel hapi konferencën e 43-të vjetore për Politikën e Sigurisë sot në mëngjes. Në fjalimin para pjesëmarrësve të nivelit të lartë nga 40 vende, kancelarja gjermane tha se bota po shndërrohet në një vend gjithnjë e më të rrezikshëm. Kërcënimeve globale mund t'u bëhet ballë vetëm me veprime të përbashkëta, tha zonja Merkel. "Sot ne kemi nevojë të ndajmë përgjegjësitë përtej zonës së Amerikës Veriore dhe Evropës".

Angela Merkel thotë se komuniteti global duhet të ndajë përgjegjësitë për gjendjen e botës. Ajo thotë se Rusia ka një rol qendror në sigurinë globale. "Jam plotësisht e bindur se përgjigjia ndaj pyetjes se çfarë forme do të marrin marrëdhëniet e ardhshme mes Bashkimit Evropian, NATO-s dhe Ruisë, do të ketë një ndikim vendimtar tek qëndrueshmëria e zonave të përbashkëta të botës. Ka një ndikim thelbësor tek marrëdhëniet me shtetet përreth dhe është e vërtetë

se Rusia ka përgjegjësi të përbashkëta me ne në shumë sfera".

Zonja Merkel i bëri thirrje Ruisë që të jetë një partnere e besueshme në tregtinë e energjisë. Ajo theksoi rëndësinë e dialogut për zgjidhjen e çështjeve mes Ruisë dhe shteteve fqinje.

Presidenti rus Vladimir Putin tha se forca ushtarake është përdorur më shumë se ç' duhet për të përballuar sfidat globale. Presidenti rus tha se nëse përdoret në mënyrë të njëanshme lufta do të vazhdojë të krijojë ndarje në komunitetin ndërkombëtar.

"Përdorimi i ligjshëm i forcës mund të realizohet vetëm në kuadrin e Kombeve të Bashkuara. Kombet e Bashkuara nuk mund të zëvendësohen nga NATO-ja dhe Bashkimi Evropian".

Zoti Putin i kritikoi ashpër planet e Shteteve të Bashkuara për të dislokuar sisteme për mbrojtjen nga raketat në Evropën Lindore. Ai tha se plani amerikan është një fazë e re në garën e armatimeve.

"Militarizimi i hapësirës, sipas mendimit të Ruisë mund të provokojë pasojë të paparashkueshme për komunitetin botëror, jo më pak sesa fillimi i epokës bërthamore".

Presidenti rus shprehu pakënaqësinë për zgjerimin e aleancës së NATO-s drejt lindjes. Zoti Putin tha se NATO-ja është një organizatë politike dhe Rusia nuk mund të jetë e kënaqur me një infrastrukturë ushtarake të huaj në kufijtë e saj. Presidenti rus përsëriti angazhimin ndaj tregëtisë së lirë. Por ai shtoi se Rusia nuk do të sakrifikojë sigurinë ekonomike për ato që ai i quajti kërkesa të padrejta për të hapur më shumë se ç' duhet tregjet ruse ndaj kontrollit prej kompanive të huaja, siç u shpreh ai.

Në konferencën triditore marrin pjesë udhëheqës të lartë politikë dhe ushtarakë. Sekretari amerikan i mbrojtjes Robert Gates do të flasë në konferencë nesër. Kryenegociatori për programin bërthamor të Iranit Ali Larijani pritet gjithashtu të flasë në konferencë. //rd//

## Veri Prifti gjuetar i suksesshëm

Rrethi i Beratit është shquar në gjithë vendin jo vetëm për kushtet e pasurit natyrore për gjueti, por edhe për numrin e madh të gjuetarëve. Disa prej të cilëve kanë bërë jehonë në veprimtaritë lokale, kombëtare, madje edhe ndërkombëtare të gjuetisë. Ndër këta gjuetarë, bën pjesë edhe Veri Prifti, banor i lagjes "Barrikadë" të qytetit tonë.

Gjatë bisedës, Veri më tregoi se kishte filluar të merrej me sport, me futbollin. Ishte aktivizuar në ekipin e shtëpisë së pionierit në fshatin Bubullimë të Lushnjes. Më vonë u aktivizua me ekipin përfaqësues "Kuçova" që drejtohej nga Mjeshtri Polizoi Ikonomi, më vonë nga Njazi Shehu e Nazif Hoxha (që të 3 trajnerë nga Berati). Veri më tregoi se ndër cilësitë pozitive si sulmues më vlerësonin si sprinter, për shkathtësi e shënues.

Pas lënies së futbollit, tregon Veri, doja të kaloja në mënyrë aktive kohën e lirë, pasi isha mësuar më parë. Dhe e gjeta, ishte gjuetia. Relievi i Beratit me pyje e pasuri kafshësh e shpendësh, bisedat e gjuetarëve për gjahun filluan të më terhiqnin edhe mua. Në vitin 1970, tregon Veri, u bëra gjuetar, anëtar i shoqatës të gjuetarëve të Beratit. Kanë kaluar afro 4 dekada dhe nga sporti i gjahut unë nuk ndahem dot.



Veri Prifti e Dragush Polovina

### Shpesh flitet që ka gjuetarë që kur kthehen bosh nga gjuetia, përsëri mburren e mburren.

Rezultatet e gjuetisë time, tregon Veri, dihen nga drejtuesit e shoqatës sonë në vite, janë dëshmitë dhe fletat e nderit në veprimtaritë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare të gjuetisë dhe të qitjes në pjatë. Sa për mburrjet e disa gjuetarëve, foli Veri, ashtu si kudo, ka gjuetare e gjuetarë.

### Në çfarë gjahu keni patur më shumë sukses?

Në gjuetinë e derrave, dhelprës, shpendëve, lepujve. Zonat më të shkelura nga mua kanë qenë zona e Tomorit, Tërpanit, Plashnikut.

### Veri, drejt a jeni kthyer bosh ndonjëherë nga gjuetia?

Të shkosh dhjetëra e dhjetëra herë pyjeve, maleve, sigurisht se jo çdo gjueti është e suksesshme, sepse varet nga shumë arsye që më mirë i kuptojmë dhe i vlerësojmë ne, vetë gjuetarët, padyshim se kam patur raste, por këto kanë qenë shumë të rralla.

### Cilët për ju kanë qenë gjuetarët më të suksesshëm?

Ka disa. Unë do të përmend Kristo Voko, Hysni Lleshi, Jani Gjyzari, Dhosi Odriçani, Lavdosh Zotaj, Beqo Qypi, Lelem Kaçeli, Hysen Qose, Robert Reveli, etj.

### Diçka për lexuesit si pjesëtar i ekipit të Beratit dy herë kampion dhe një herë nënkampion në kampionatet kombëtare të qitjes në pjatë.



Në foto:  
Afrim Mema,  
Veri Prifti,  
Dragush Polovina.

Një gjuetar i mirë, është padyshim edhe një qitës i mirë në pjatë, sigurisht nëse e dashuron dhe e vlerëson këtë sport, shprehem kështu, pasi duhej bërë stërvitje me dëshirë dhe kjo mua nuk më ka munguar. Unë sportin e qitjes në pjatë, e kam vlerësuar ashtu sikundër edhe gjuetinë e lirë dhe kjo ka qenë një ndër shkaqet e arritjeve të mia.

### Së fundi, diçka për anën financiare si gjuetar

Ç'është e vërteta, vite më parë kishim të ardhura nga gjuetia, pasi edhe zonat ishin më të pasura me gjah, ndërsa kushtet sot janë më të vështira, pasi ka zona të shkreta, megjithatë, ushtrimi i gjahut nga ana ime, është tashmë si një sport, që ashtu sikundër dihet jo çdo sport është burim i të ardhurave financiare.

Vlash Pambuku



Veri në qendër



Stavri BOBO

# Familje artistësh e Refat Dajkos

➔ Nostalgjia për artin skenik siç është drama, hedh dritë në vitet 1956-1957 e më vonë në interpretimin plot pasion të aktorëve diletant, por me një nivel të lartë artistik e profesionistë në qytetin e Kuçovës. Më kujtohet si sot në dramën “Motra e vogël” (dramë ruse), aktori Sokrat Bano në rolin e aviatorit, aktorja Liri Bandilli, hyjnesha skenës (vazhdonte vitin e fundit të shtatëvjeçares) në rolin e motrës, Sevi Rrumbullaku si dhe aktorin e madh të atyre viteve Refat Dajko, i cili në vitet e mëvonshme në Kuçovë bëri emër, ku në enciklopedinë për Kuçovën cilësohet: “Simbol i artit në Kuçovë”. Ky është një vlersim i madh që i bëhet këtij aktori të dramës. Për këtë dhe në bashkëkohësit e tij që kemi ndjekur me shumë kënaqësi lojën e tij aktoriale në ato vite, na gëzon pa masë, se ka qenë një aktor i veçantë, interpretonte me shpirt e pasion, duke krijuar një figurë të një niveli të lartë artistik, në mjaft role në drama të ndryshme që janë vënë në skenë në ato vite nga pallati i kulturës në kinoklubin “18 Tetori” në Kuçovë. Kjo dramë bëri jehonë.

Arti skenik dhe estrada në të dy qytetet Berat e Kuçovë kanë qenë djepi i artit, të cilat kishin vlera të mëdha, ku me dhjetëra aktorë me interpretimin e tyre të magjishëm, i kanë dhënë jetë e gjallëri popullit të tyre. Ndërsa sot në ditët tona është për të ardhur keq. Bëhet një jetë e zbrazët e monotone. Ky art i bukur mjaft edukues është venitur për të mos thënë se është shuar. Megjithatë premtimet e bujshme që janë bërë, le të mbetemi me shpresë se një ditë do të bëhet mbarë, kur në skenat e qyteteve tona të lindë përsëri ky art i bukur e magjepës. Le të fillojmë vullnetarisht e të mos rendim tek paraja. Ta bëjmë ashtu siç e nisi rrugën e tij, ish-grupi karakteristik i këngës popullore qytetare “Gorica”, sot grupi popullor i këngës qytetare me emrin “Berati”, i institucionalizuar.

Pra, kam besim se organet vendore të dy qyteteve tona do të na kuptojnë, vlerësojnë e do të na ndihmojnë që arti i dramës dhe i estradës të rifillojë së shpejti. Populli i qyteteve tona ka mall të shikojë dramë e bukura si dikur, si “Vajzat e komitit”, drama “Babë Dudë Karbunara”, drama “Heronjtë e Linasve”, “Dy krisma në Paris” e shumë të tjera.



Nga e djathta aktori Refat Dajko në rolin e inxhinier Muhamet Shehut. Nga e majta (heroi Myrteza Kepi) Drama “Heronjtë e Linasve”

**E**nisa shkrimin kështu për të krijuar një imazh, për të sjellë në kujtesë ato figura të artit të qyteteve tona e për t'i rikujtuar kontributin që ata kanë dhënë ndër vite dikur në artin skenik.

Protagonisti i këtij shkrimi është ish-aktori i dramës së qytetit të Kuçovës Refat Dajko. Duke qenë vetë i apasionuar, gjë që e kam debutuar gjatë viteve, një mbrëmje vonë hedha disa mendime në letër. Kujtesa më çoi në vitet e rinisë dhe para meje m'u pasqyruan ata njerëz të thejshëm të artit, të cilët me punën e mundin kanë dhënë kontributin e tyre. Por koha kalon e ata janë plakur. Ajo që është më e keqja janë harruar. Ishte mëngjes i një dite të hëne, fundi i muajit gusht, kur unë nisa udhëtimin tim në drejtim të qytetit të naftëtarëve, Kuçovës. Të atyre naftëtarëve herioikë të cilët kanë bërë sakrificë sublime duke punuar në vështirësitë e dimrit në shi e dëborë e baltë, ditë e naftë në kërkim të nxjerrjes së arit të zi. Pranë sondave ku tavllorotat rrotullonin astrat e shpimit, për t'i rrëmbyer nëntokës naftën. Isha në kërkim të naftëtarit dhe aktorit veteran 72-vjeçar Refat Dajko, i datëlindjes 11 janar 1935 në Kuçovë.

Pas disa orë mundimesh, munda të gjej banesën ku jeton dhe sot në periferi të qytetit ish-aktori, simbol i artit në Kuçovë Refat Dajko.

Pritja ishte e bujarisë shqiptare. Por e befaso i vajtja ime dhe aq më tepër nuk më njihje. Pasi u prezantuam, shpjegova qëllimin e këtij takimi.

Një gjë më befaso i dhe njëkohësisht më çuditi shtëpia e tij. Pyes veten: Ishte shtëpi, apo galeri artesh? Kuptova që kjo shtëpi ishte “trashëgimi e brezave në art”. Në këtë familje ishin të gërshetuara si drama, muzika dhe arti i pikturës.

Kërkova të më fliste për jetën e tij. Si i lindi dëshira, pasioni për artin e dramës, cilët kanë qenë rolet dhe suksesi që ka patur në interpretimin e tij. Cili ka qenë roli më i spikatur dhe drama që i ka pëlqyer më shumë. Pasi më foli për jetën dhe aktivitetin e tij e të nipërve, mbeta i befasu. Thashë me vete: “Pse këta njerëz janë harruar? Ç'fatkeqësi! Refati që në fëmijërinë e tij ishte i apasionuar pas artit të dramës. Që në ditët e para të çlirimit Refati i vogël me shoqet e shokët e tij në lagje, improvizonte me çarçaf skenën dhe lozin me pushkë druri duke imituar partizanët dhe gjermanët të ndarë në dy grupe. Që në moshë të re Refat Dajko hyri në ndërmarrjen e prodhimit, ku mësoi profesionin elektroaut. rreth viteve 1951-1952. Krahas punës, ai iu fut artit të dramës që ishte profesioni i tij. Roli i tij i parë ishte episodik në dramën “Lagja e varfër”. Këtu fillon rruga e tij e dramës në të cilën Refati do të bënte emër si aktor në qytetin e Kuçovës. Gjatë viteve Refati debutoi në shumë drama duke interpretuar në mjaft role të spikatura. Refati punoi me aktorin dhe regjisorin e madh të asaj periudhe siç ishte i madhi Gjon Hila, shkodran, ku mësoi shumë dhe u formua si aktor drame.



Pamje nga drama “Heronjtë e Linasve”, Kuçovë. 1972, nga e djathta aktori Refat Dajko, në rolin e inxhinier Muhamet Shehut

Loja e tij aktoriale pëlqejë shumë nga spektatori.

Jemi në 15 shkurt të vitit 1967. Në stacionin e pompimit të naftës në fshatin “Linat” të Cërrikut, stacion ky që shërbente për shtytjen e naftës sipas drejtimit të caktuar, ndodhi një ngjarje e rëndë. Shpërthen flaka. Duheshin mbyllur saraqineskat që të shuhej zjarri. Inxhinieri Muhamet Shehu nga Bicaj i Kukësit dhe Myrteza Kepi nga Tirana, pa marrë parasysh rrezikun për jetën, u hodhën nëpër flakë për të shpëtuar pasurinë kombëtare siç ishte nafta. Saraqineskat u mbyllën, por flakët i përfshinë këta heronj të cilët vdiqën. Ky heroizëm i këtyre djemve të rinj, bëri jehonë në të gjithë Shqipërinë. Vepra e tyre u ngrit dhe në art, për të mos vdekur kurrë. Për këtë artisti i populli Sulejman Pitarka, këtë heroizëm e përjetësoi në dramë, duke i vënë titullin dramës “Heronjtë e Linasit”. Drama filloi të punohet në tavolinë Sulejmani i drejtohet Refatit duke i thënë: “Juve do të luani rolin kryesor të dramës, të heroit të Linasit, të Muhamet Shehut. Tek ty kam besim dhe me punën aktoriale të përgjithshme që do të bënë dhe shokët, do të arrij që drama të ketë një sukses të madh. Kjo dramë u vu në skenë nga autori dhe regjisorin, Artisti i Popullit Suljman Pitarka. Për vënien në skenë të kësaj drame, vuri të gjithë energjitë e tija mendore, fizike, dituritë e tij teorike dhe eksperiencën e tij në dramaturgjë. Punoji me një përkushtim të pashembullt, ku pruri në skenë në mënyrë origjinale jetën dhe heroizmin e punonjësve dhe inxhinierëve të talentuar të naftës. Drama u shfaq rreth viteve 1972 në Kuçovë, Berat e në gjithë Shqipërinë. Kjo ngriti peshë zemrat e shqiptarëve. Ishte një sukses

i madh. Kjo dramë u shfaq dhe në Kukës, në vendlindjen e heroit naftëtar, Muhamet Shehut.

Populli i Kukësit i bëri një pritje madhështore, trupës së teatrit të qytetit të Kuçovës dhe në veçanti aktorit të madh Refat Dajko, që interpretoi figurën e heroit, të djalit të tyre, inxhinierit Muhamet Shehut.

Po kështu dhe në Tiranë në vendlindjen e heroit të dytë Myrteza Kepit. Suksesi i trupës ishte i madh.

Por Refat Dajko kishte fituar një eksperiencë të pasur për artin dramaturgjik, për organizimin, drejtimin dhe vënien në skenë të dramave të ndryshme. Në këtë drejtim kontributi i këtij artisti në ndërmarrjet e naftës ka qenë i madh. Punën më të madhe, me dramën e ka patur në ndërmarrjen e komunales. Në festivalet e teatrove si midis ndërmarrjeve dhe ato të shkollave Refatin e kanë caktuar kryetar jurie. Ai ka qenë dhe konsulent në pallatin e kulturës “18 Tetori” në dhënie të mendimeve për artin. Por tradita e artit në këtë familje kuçovare po i transmetohet brezave. Kështu dy djemtë e Refatit, Abazi dhe Kenari, janë muzikantë popullorë. Abazi është fizarmoniçist. Kanë qenë pjesëmarrës të festivaleve folklorike.

Të dy këta djem kanë orkestrën e tyre e punojnë në dasma e gëzime familjare.

Evis Dajko, djali i Abazit dhe nipi i Refatit, i apasionuar në artin e pikturës, qysh në moshë të vogël dallohej ndër fëmijët për talentin në këtë fushë.

Ishte vetëm 13 vjeç kur hapi për herë të parë ekspozitën e tij me piktura shumë të bukura që befasuan autoritetet vendore në qytetin e Kuçovës. Në këtë kohë vazhdonte klasën e shtatë. Por, talenti i tij s'mbaron me kaq. Në vitin 2002 pikturat në vaj ishin fantastike për moshën e Evisit. Ka mbaruar liceun artistik “Jordan Misja” në Tiranë, degën e pikturës, skenografi. Tani Evisi vazhdon shkollën e lartë të pikturës në Gjermani, ku dhe vlerësohet.

Nipi tjetër i Refatit (djali i vajzës), Nasjol Rozgari, është futbollist i talentuar, sulmues me ekipin “Naftëtarit”. Fillimisht ka lozur me para të rinjtë, ku u dallua si talent në artin e futbollit. Ka rreth tre vjet që tashmë luan me ekipin e “Naftëtarit”.

Siç shihet, familja e artistit të dramës Refat Dajko me të vërtetë përbën një ansambël të tërë artistësh, për të cilët ai është krenar. Me të drejtë krenohet populli i Kuçovës për simbolin e artit të qytetit të vet. Refat Dajko për kontributin që ka dhënë si dhe vazhdojnë të japin brezat e familjes së tij, do të kujtohet ndër vite me repsekt si një nga aktorët e dramës që ka bërë emër.



Aktori Refat Dajko ng ae majta. Piktori i vogël Evisi në mes kryetari i bashkisë Kuçovë dhe gjyshit Refat Dajko

## Ngjarje e jetuar në prag të zgjedhjeve

Luftar SPAHIU



## Të provosh gëzimin dhe deziluzionin

**P**unonte në kooperativë atje ku e çonin. Pranonte aq pikë sa i jepte brigadieri. Nuk ankohej për asgjë. Thujse ishte një makinë pune e heshtur, e heshtur në pafundësi. Heshtte dhe kalonte nëpër mend gjashtëmbëdhjetë vitet e burgut. E kishin tjetërsuar djalin e gjallë, të shkathët që nuk ia hante qeni shkopin. Ishte rrëgjuar fizikisht, i kursyer në të folur, por karakteri i ishte forcuar edhe më. Ishte bërë si puna e çelikut, të temperuar.

Edhe në shtëpi ruante po atë natyrë të heshtur duke u treguar thujse inegzistent. Erërat e perëndimit që filluan në Evropën Lindore sikur ia zbardhën pak limontinë e shpirtit.

Vitet e burgut ia kishin mprehur nuhatjen politike.

Në ditët e lëvizjes studentore sikur nuk po e mbante vendi. Në një pasdarke të vonë u tha djemëve:

-Më duket se po afron dita jonë. Djemtë e panë: panë edhe njëri-tjetrin dhe vetëm sa bënë buzën në gaz duke iu përshtatur natyrës së tij. Formimin e Partisë Demokratike e priti me lot gëzimi: ndonëse e gërryente përbrenda ajo që në krye të saj ishin ish-komunistët.

-E dredhin ata e dredhin,- mendonte me

vetë ai,- janë farë e keqe ata.

Më pas shtonte: -Ti heqim qafe një herë këta, pastaj me të parë e me të bërë.

Humbjet në zgjedhjet e nëntëdhjetë e njëshit i përjetoi me dhimbje të madhe, ndonëse drejtuesit e partisë dhe të këshillit kishin ndryshuar shumë me të. Po i flisnin me ngrohtësi, ndalonin këmbët dhe e përshëndetnin me gojën plot dhe jo si më parë. Në zgjedhjet e nëntëdhjetë e dyshit e ndiente veten as në qiell as në tokë. Mezi po priste të vinte ora tetë që të dëgjonte informacionet. Fillimisht informacionet vinin të paqarta. Ai nuk e dinte se partia në pushtet mendohej ta mbante sa më të fshehtë rezultatin dhe ta shtynte sa të mundej dhe më tej humbjen e saj. Djemtë dhe gruaja edhe e bënë një sy gjumë me copa, por ai nuk mbylli sy.

Ora gjashtë i gjeti të gjithë duke dëgjuar informacionin në radio. Lajmi i gëzimit u dha. Ai edhe tani mbeti shtang. Mbeti ashtu i ngrirë se kishte frikë nga zhgënjimi. Sa herë ishte zhgënjyer me ato lajmet që s' dinte kush dreqin i shpifte për lirim të parakohshëm. Gëzohej e më pas binte në dëshpërim. Edhe atë çast kur i thanë të merrte plaçkat e të ikte, shokët e përqafojnë e ai qëndronte si hu.

Tani donte të gëzonte, por s'guxonte.

Me t'u dhënë lajmi, djemtë thërritën gëzueshëm:

Të dy u hodhën në krahët e të atit me një përqaftim të kushedi sa pritur.

-Selman! -thërriti e shoqja. Djemtë të shkëputur nga ati i tyre, panë të ëmën t'i hidhej në një përqaftim të zgjatur. Ata kurrë nuk i kishin parë prindërit të përqaftuar me aq dashuri. Kur ishte kthyer nga burgu, ata ishin përqaftuar sa për të thënë. Ai kishte dalë nga burgu i vogël për t'u kthyer në burgun e madh, ndaj dhe përqaftimit i kishte munguar ngrohtësia. Dita kishte aguar mirë. Selmani u vesh me rrobat më të mira dhe bëri për nga shtëpia e Daur Beqirit; pushkatarit të fshatit.

Dauti u çudit disi me këtë vizitë kaq të hershme, por nuk e la të priste. E ftoi brenda.

-Jo, jo le të bisedojmë këtu.

-O po do të vish brenda se s'bën.

Nga këmbëngulja e tij, nuk hezitoi për më gjatë. Ngjiti tri katër shkallët dhe u gjend në verandë.

-Ja, mirë se erdhe.

-Mirë se ju gjeta.

-Grua, na bëj dy kafe.

Gruaja doli, takoi mysafirin dhe shkoi për të sjellë pas pak kafetë. Duke gjerbur nga pak kafen, Selmani foli:

-Daut, a e di pse kam ardhur?

-Jo për nder nuk di gjë.

-Dua pushkën me tre fishekë. Dua të përshëndes fitoren e partisë sime. Ti je burrë i mirë, i qetë dhe i mençur. Do ta qëlloj, tri herë dhe fishekët do t'i paguaj jo me tetëdhjetë, por me 500 lekë!

-Po ti kërkoke të më futësh në burg!

Selmani vuri buzën në gaz e më pas shtoi:

-Tani pushteti është imi. Nuk do të ketë burg për ty. Ma bëj këtë nder dhe unë do të di të ta shpërblej.

Dauti u ngrit nga vendi, mori pushkën që ishte varur, i vuri tre fishekë në gushë dhe ia dha.

Të dy dolën nga shtëpia dhe morën rrugën për nga zyrat. Atje vunë re një grup njerëzish.

Ata i kishin njohur nga larg të dy burrat. Dy burrat ndaluan mu në mes të sheshit.

Selmani vuri re se burrat që gjetën aty ishin në ankth. Ata sikur po provonin lëvizjet e para të një tërmeti të fuqishëm të cilit nuk po ia merrnin me mend fundin. Selmani hoqi pushkën nga supi; e çliroi nga siguresa e drejtoi me tytën lart dhe e shkrehu tri herë. Burrave përballë nuk iu dukën tri të shtëna pushke, por topi. Selmani lëshoi pushkën përdhe dhe e mbasi vuri të dy duarët rreth përpara gojës, lëshoi një thirrme vikamë si malësorët në betejat për fitore:

-He, he he he he he eeej. Fituam, ore hej, heeej fitum!

Pas saj ra një heshtje varri. Mori pushkën nga toka dhe ia çoi Dautit, i cili qe ulur te shkallët e lapidarit duke i lënë mbi gjunjë tri pesëdhjetëshe.

Ai nuk deshi t'i pranojë, por Selmani mori rrugën e u largua.

Nga mbasdjtja vonë kishin ardhur katër punonjës policie.

-Nuk keni punë me Dautin. Jam unë fajtori. Në shtëpi nuk kishte njeri dhe unë e mora pushkën pa pyetur. Në degë do të vij unë, por tani u bë natë, ndaj hajde të kalojmë bashkë sonte. Unë kam festë sot dhe për ditë gëzimi e ruaj një pikë raki. Ata nuk ndenjen. Mëngjesi i nesërm e gjeti Selmanin në degë. Pas një debati të kotë e mbyllën bisedën.

## Papagalli që imitoi politikanin

Politikanit në fjalë i ra për pjesë që të garonte si kandidat për në forumet drejtuese të pushtetit vendor në një zonë të thellë malore.

I shoqëruar edhe nga personalitete të tjera të partisë së tij ai udhëtoi për në atë zonë ku populli para të cilit do të prezantohej ishte grumbulluar në një shesh që mbahej edhe si kryeqendra e atyre fshatrave.

Mbledhjen e hapi kryetari i nëndegës së partisë përkatëse, i cili, mbasi bëri një rezumë të shkurtër për sukseset e mossukseset e zonës, prezantoi dhe kandidatin e rekomanduar nga qendra, të cilit i dha fjalën.

-Të nderuar zotërinj dhe

zonja,- e nisi fjalën e tij kandidati duke mbajtur para gojës megafonin.

Ndërkohë një papagall që e kishte sjellë nga vendet tropikale një emigrant, kishte mundur të ikte nga kafazi dhe ashtu i lirë duke qëndruar në degën e një peme aty pranë nisi të imitojë politikanin:

-Të nderuar xhotelinj e xhonja!- përsëriti me vështirësi papagalli.

-Unë angazhohem se do të ndreq rrugë dhe ura!- zotohej kandidati.

-Unë angaxhohem se do të dleqos lug dhe ula!- përsëriste papagalli duke zëvendësuar r-në me l-në. Këtu të pranishmëve sikur po u kapte veshi diçka të dyshimtë, por

kujtonin se kjo përsëritje ndodhte si defekt i jehonës, prandaj dhe nuk po i kushtonin vëmendjen e duhur.

-Unë ju premtoj se uji dhe dritat s'do të mungojnë për njëzet e katër orë!- vazhdonte të angazhohej politikanin.

-Unë ju plemtoj se uji e dritat do të mungojnë për njëzet e katër orë!- e përsëriti duke e katranosur papagalli.

Mirëpo kjo e fundit u dallua qartë jo vetëm nga publiku, por edhe nga oratori se dikush po tallej me personalitetin e tij. Disa aktivistë u shpërndanë përreth duke kontrolluar nëpër shkurre por nuk gjetën njeri për të dyshuar.

-Dëgjoni more popull! Mos ia vini

re atij maskarai të ndyrë e mashtrues!- bërtiti i nervozuar politikanin duke menduar se imituesi i padukshëm i përkiste spektrit të krahut tjetër.

-Dëxhoni mole popul! Mos ia vini re atij maskalai të ndylë e mashlues!- u dëgjua zëri i i lartë e i çjerrë i papagallit.

Tashmë njerëzit panë ashiqare shpendin e vogël, i cili me dhuntinë e tij jo vetëm që mitingut elektoral i dha tonin e humorit, por për momentin imitimet e tij vlenin më tepër si apel për të mos i besuar politikanit se sa thjesht një transmetues. E ndërsa njerëzit ishin duke qeshur me këtë zog të mrekullueshëm papagalli nga ana e tij, ndonëse duke imituar qeshi bashkë me turmën.

Enver Troka



# Kur Shqipëria shpallej kampione e Ballkanit

■ Vazhdon nga numri i kaluar

## Gjykimi historik i Shqipërisë kampione e Ballkanit

Për vite merita e madhe e Ballkaniadës është identifikuar vetëm me meritën e regjimit, duke harruar se jo më Shqipëria, por bie fjala, as shpikësja e futbollit, Anglia vetë, pa një të kaluar nuk do të mundte që brenda 20 muajve të formonte një skuadër kampione të Ballkanit, për më tepër në duel me Jugosllavinë dhe Rumaninë, pjesëmarrëse të kampionateve Botërore të viteve '30, pra me një traditë të jashtëzakonshme. Për hir të së vërtetës duhet të pranojmë, në fund të këtij Dossier-i të "Lajmëtarit" se fitorja e titullit Kampion i Ballkanit, më tepër është sinjikativi i Kampionateve të Paraluftës se sa të këtyre të mesit të viteve '40. Të parët triumfojnë në dy drejtme: vunë bazat e futbollit dhe i sollën kësaj Shqipërie 1946 plot 6 protagonistë, të cilët i kishin lindur ata kampionatet të viteve '30: Tahiri (ndonëse jo në Shqipëri, por në Malin e Zi), Llambi, Fakja, Teliti, Borici. Dhe jo këto kampionate. Sepse sot, mbas zbulimit të tri kampionateve kombëtare të futbollit nga Italia fashiste më 1939, 1940, 1942, nga i mirënjohuri gazetari sportiv Besnik Dizdari (kampionatet që patëm mundësi të pasqyrojmë në gazetën "Lajmëtari", vetëm ndeshjet e "Tomorit"), del se edhe kampionet e tjerë të Ballkanit, si Dibra, Spahiu, Demneri, Fagu, Biçaku, Parapani, Kavaja janë prodhim i këtyre kampionateve të viteve '40 të Luftës.

Ndërkaq vitet '40 që sapo kishin filluar për regjimin, kanë meritën se kishin bashkuar dy dekada në një dhe se ky regjim diti të organizonte për së mbari kombëtaren e Shqipërisë të lindur më 1936. Nga ana tjetër, nuk mund të harrohet kurrë që edhe pse trajneri i parë është Ljubisa Brocic, Adem Karapici, sidomos, por edhe Bik Jakova, figura të mëdha të futbollit shqiptar të Paraluftës, duke qenë bashkëtrajnerë, madje Karapici, i cili vinte më

lart në kulturën perëndimore të llojit, edhe se sa vetë Brocic. Ndërsa përsa i përket vlerave të fushës së blertë, përsërisim tri kampionatet e Luftës të Besnik Dizdarit, kanë qenë vendimtarë për një formim futbollistik, që çoi në formimin e kombëtares më 1946. Vëreni, pra, se si me përfundim të Pal Mirashit, të gjithë lojtarët shqiptarë, kampionë të Ballkanit, vijnë nga këto kampionate, kur Loro Boriçi dhe Sllave Llambi vijnë nga kampionatet të serie A dhe B të Italisë së fillimit të viteve '40, shtu këtu dhe dyshen e portierëve italo-malazesë Poselli-Tahiri.

Nga ana tjetër, asesi nuk mund t'i mohohen meritat e Shqipërisë "së re komuniste" të sapothemeluar, e cila me zgjuarësi dhe me pasion sa politik aq dhe sportiv, ia arriti që falë kuadrove të edukimit fizik të mbretërisë, të organizonte Lojërat Ballkanike, që pavarësisht nga mungesa e Greqisë dhe e Turqisë, prapëseprapë qenë shembullorë. Lojëra që luajtën një rol të jashtëzakonshëm për ecurinë e mtejshme të sportit shqiptar dhe u bënë një themel në kulturën sportive, në zhvillimin e atletikës dhe të futbollit në Shqipëri, në vetë përvojën e organizimeve sportive në tërësi.

Kanë kaluar 60 vjet dhe ndjehemi disi të lehtësuar që për herë të parë përmes trajtesës historike të Dossier-it të "Lajmëtarit", ia arritëm të tregonim më të mundshmen e kësaj historie sportive- gjeopolitike për të cilën deri më sot nuk është mbajtur një qëndrim dhe trajtim i saktë historik. Dhe e mbyllim me pyetjen tonë retorike: përse nuk u përkujtua 60-vjetori i Lojërave Ballkanike?

Ose më fort: përse asnjëherë nuk janë përkujtuar deri më sot Lojërat Ballkanike 1946 dhe protagonistët e saj?

Po çka kemi përkujtuar ne përsëmbëri dhe me paanshmëri në jetën tonë sportive, madje në historinë tonë në tërësi?...

Përgatiti V. Buda

## Kur Shqipëria shpallej kampione e Ballkanit

Ky shkrim special i dossierit të "Lajmëtarit Sport", ka të bëjë me garat e atletikës, çka deri më sot askush nuk ka folur. Faktet që janë treguar në shkrimet e kaluar, shumica e të cilëve u paraqitën, po për herë të parë mbas 60-vjetëve pasohen me trajtesën e sotme nga të tjerë, po aq të fshehur.

### E vërteta historike për Lojërat Ballkanike të Tiranës të vitit 1946, e para veprimtari shumësportive shumëshitetase në Evropën e mbasluftës.

## Manifesti i bujshëm i 5 tetorit 1946

Ai u quajt thjesht një veprimtari sportive, emërtuar me një përcaktim që më pas nuk u përdor kurrë në Shqipërinë komuniste: "Parada e Madhe Sportive" u zhvillua më 5 tetor 1946, në bulevardin "Dëshmorët e Kombit", përballë tribunës së vendosur para hotel "Dajtit" në praninë e udhëheqësve Nako Spiru, Haxhi Lleshi, Tuk Jakova, Omar Nishani, të renditur siç po i paraqesim, çka, mesa duket, tregonte rëndësinë e secilit në shkallëzimin partiako-luftarako-shtetëror. Duke i parë emrat menjëherë vërejmë se me përfundim të Haxhi Lleshit, të gjithë të tjerët, kush më rëndë dhe kush më lehtë, u zhdukën apo u mënjanuan prej vetë partisë së tyre. Madje katër prej tyre u shuan prej plumbit. Paradën e çel ndërkaq, ministri pa portofol, Tuk Jakova, i cili midis të tjerave, në drejtshkrim të kohës, thotë: "Fakti që në kryeqytetin e Shqipërisë po zhvillohen lodrat ballkanike në një kohë kur përtej kufijve tanë fashistë e Athinës me gjak, me terror dhe me luftë po përpiqen t'i imponojnë popullit grek skllavërinë, tregojnë qartë ndryshimin e madh që ekziston midis shteteve të lira dhe demokratëve të Ballkanit dhe në mes të një shteti

fatkeq si Greqia, ku mbretëron anarshia dhe terrori". Ky është thelbi i njëanshmërisë komuniste (të shteteve komuniste) të Ballkaniadës 1946, e cila në të vërtetë qe themeluar para luftës, prej shteteve antikomuniste. Ky është thelbi i politikës së vendosjes së diktaturës për dy shteteve të tjera ballkanike, Greqi e Turqi, që nuk kishin ardhur në garat e mëdha të Tiranës.

Ndërkaq, në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" të Tiranës, Rato Dugonjiç, Marin Vzharov, Odiseu Parvielsku, përshëndesin paradën e 5 tetorit, nën të njëjtin ton entatik të një "demokracie të vetme të Ballkanit", që ishin Shqipëria, Jugosllavia, Bullgaria dhe Rumania. Një përmbajtje e tërë çka i jepte Ballkaniadës, po një përmbajtje të theksuar sa politike, po aq propagandistike në të mirë të vendeve satelitive të Stalinit. Sidoqoftë, ana më sportive duket në fjalën përshëndetëse të Kristo Papajanit, sekretar i përgjithshëm i Federatës Sportive Shqiptare, i cili njofton me kranari se "ne kemi zhvilluar një sport për masat e gjëra të popullit, për punëtorët dhe fshatarët, duke ngritur 17 klube sportive me 12 000 anëtarë me 11 kampioante kombëtare, çka përbënte një të vërtetë sportive të kohës

pavarësisht nga harrësia për themelimet: më shumë se gjysma e këtyre klubeve qenë themeluar qysh në vitet '10, '20, dhe '30. Parada e 5 tetorit, me parakalimin madhështor të fizikulturistëve dhe sportistëve për herë të parë në histori, mu në qendër të Tiranës, sidoqoftë pavarësisht nga politizimi, përbën një gjë po aq të paparë për Shqipërinë. Parakalojnë sportistët e Ballkaniadës, por edhe rini sportive, nxënës, fëmijë, sindikalistë të epokës, ushtarakë dhe papritmas për herë të parë shihen portrete gjigande udhëheqësish të mbajtur lart mbi supet e njerëzve. Ahmet Zogu natyrisht që s'kishte mbërritur deri këtu, Enver Hoxha i Shqipërisë, Josif Broz Tito i Jugosllavisë, Georgi Dimitrov i Bullgarisë dhe Petër Groza i Rumanisë stepin publikun e Tiranës anës bulevardit, publik, i cili i vetëdijshëm apo i pavetëdijshëm herë duartroket dhe herë habitet i marrun mendsh! Në këtë ditë "historike" shfaqet për herë të parë stema e Republikës së re popullore më gjigande se kurrënjherë e vendosur mbi një makinë të madhe

me yllin e kuq që "vezullon" në krye të saj. Mandej, po këtu në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" para hotel "Dajtit" shfaqen të rinjtë e shumë shqiptarë, të cilët mbajnë në duar drapërin dhe çekanin si simbol të ndërtimit komunist të stilit sovjetik. Vetvetiu, gjithçka është madhështore dhe e paparë në vetë historinë e Shqipërisë në këtë ditë të 5 tetorit 1946. Madje pa pushim gjithë ditën, duke u mbyllur në mbrëmjen po madhështore të valleve, muzikës, hareshë, euforisë. Tirana dukej vërtet diçka tjetër përgjithë historinë e saj në këtë mbrëmje panballkanike të sportit dhe politikës, të kujtimit të luftës dhe paqes enigmatike që po mbërrinte, të pasionit sportiv rinor dhe "miqësisë" së katërshes së famshme të Ballkanit, asaj Jugosllavi-Rumani-Bullgari-Shqipëri. Ky ishte stili i ri që tashmë si një uragan po shndërronte qiellin e kaltërt të Shqipërisë, qysh prej këtij 5 tetori 1946 e deri andej kah vitit 1990! Vendine kishin marrë ndër duar mjeshtrit e propagandës.

## Dokument: Cilët qenë ballkaniadasit?

Dhe tani le të vështrojmë në mënyrë më prozaike, për hir të historisë, gjithnjë për herë të parë mbas 60-vjetëve, njerëzit e Ballkaniadës 1946. Përsërisim: për t'i sjellë në histori për herë të parë mbas 60 vjetëve, për t'ia shpëtuat vetë historisë, të cilën edhe në fushën sportive, ende nuk e kemi shfaqur dhe zbuluar të tërë. Ballkaniada e Tiranës 1946 ka patur si kryetar të saj, të atij që ishte emërtuar si Komiteti Superior i Lojërave Ballkanike, Kristo Papajani, i cili ishte sekretar i Përgjithshëm i Federatës Sportive Shqiptare (FSSH). Anëtarë të këtij komiteti Superior ishin, Rato Dugonjiç i Jugosllavisë, Marin Vzharov i Bullgarisë dhe Georgi i Likardiopol i Rumanisë. Komiteti kishte edhe Drejtorinë e tij Administrative me drejtor Hulo Hadërin dhe anëtar: Anton Mazrek, Spiro Shuteriqi dhe Josef Maliç i Jugosllavisë. Komisioni i Atletikës kishte kryetar (Jugosllavi), Virgil Juan (Rumani), Jordan Galabof (Bullgari) dhe Eqrem Stërmasi (Shqipëri). Komisioni i futbollit kishte kryetar Anton Mazrekun dhe anëtarë Llazar Lipivanin, Arsienevic (Jugosllavi), Milef (Bullgari), Belu (Rumani), këshilltarë teknikë ishin Luigj Shala, Pavle Jovicevic (Jugosllavi), Gallobodan Jordan (Tumani), Dr. Arnaut Juan (Bullgari). Dhe doemos, Ballkaniada kishte edhe vperimtarë të tjerë, ku shqiptarët përbënin shumicën. Kemi kënaqësinë t'i përmendim të gjithë, dukei vendosur sipas rendit botues të asaj kohe.

**JURIA:** Dervish Lisi, Hajdar Biçaku, Xhevdet Skilja, Vasil Naqi, Zef Hila, Ismail Kulla, Ibrahim Dizdari, Aqif Domini, Avni Zajmi, Pjerin Guraziu, Petraq Musha, Angje Berisha, Petraq Leka, Xhavit Saraçi, Qamil Shehu, Safet Gjata, Elez Maha, Rexhep Rama, Adem Karapici.

**KRONOMETRISTA:** Besim Qorri, Jorgji Mano, Shaban Toptani, Shefqet Tirana, Fahri Sulo, Niko gjini, Jani Leka, Thoma Nushi.

Kalojmë tek sportistët shqiptarë të mbledhur dhe pjesëmarrës të drejtëpërdrejtë në gara e ndeshje, pra të gjithë papërfundim. Kësisoji dhe ata që nuk arritën të merrnin pjesë në gara për historinë janë zyrtarisht pjesëtarë ballkaniadas.

**ATLETIKË MESHKUI:** Skënder Begeja, Galip Sojli, Belur Hatibi, Selim Dibra, Zisi Kondi, Adem Smajli, Tahir Puka, Ligor Sovjani, Mihallaq Mina, Shefqet Puka, Sotiraq Manushi, Zef Franja, Feti Dizdari, Xhevat Bozgo, Zef Laca, Shahin Vala, Luigj Bojani, Besim Borici, Vlash Koljaka, Taf Dafa, Hajrulla Tuzi, Thoma Thumbo, Sllave Llambi, Fadil Bushati, Sherafedin Gjilani, Hamdi Muça, Besim Dermoz, Mehmet Bajraktari, Qemal Isaj, Daut Bogdani, Xhemal Harro, Gjergj Marku, Xaf Selmani, Hasan Kroshti, Vehbi Dibra, Ymer Jusufi, Hamdi Hoxha, Kasëm Rexhepi, Ibrahim Mjollli, Tef Stërmasi.

**ATLETIKË FEMRA:** Shpresa Spahiu, Selime Shpuza (Shkupi), Marie Rranzi, Violeta Rama, Gjylter Pipa, Aneta Baba.

**FUTBOLL:** Bahri Kavaja, Skënder Begeja, Aristidh Parapani, Hivzi Sakiqi, Qamil Teliti, Rexhep Spahiu, Foto Janku, Xhavit Demneri, Sllave Llambi, Muhamet Dibra, Giacomino Poselli, Dod Tahiri, Loro Boriçi, Vasil Biçaku, Pal Mirashi, Bimo Fakja, Xhelal Juka, Beqir Borici, Preng Gjeshi, Besim Fagu, Hamdi Bakalli. Këta ishin, të treguar për herë të parë mbas 60 vjetëve. Duhet t'i nderojmë, sepse deri tani, shumicën nuk e kemi nderuar asesi. Janë pionierët e sportit shqiptar të zyrtarizuar të mbasluftës, ndërsa gjashtë vajzat, Spahiu, Shkupi, Rranzi, Rama, Pika, Baba, janë femrat e parat shqiptare që marrin pjesë për herë të parë në një veprimtari sportive ndërkombëtare. Sot e kësaj dite, as ato nuk i kemi nderuar. Pa harruar ndërkaq shumë emra prej sportistëve të cilët, jo veç më Shqipëria nuk i ka nderuar, por edhe i ka dënuar. Më e pakta, për aq sa kemi mundur të dokumentojmë, Ibrahim Dizdari, Aqif Domini, Pjerin Guraziu, Luigj Shala, Galip Sojli, Feti Dizdari, Luigj Bojani, Sabri Dajlani, Vasil Biçaku, Gjylter Pipa, Raq Manushi, Adem Karapici, por dhe të tjerë plot, biografia do t'i ndiqte gjithë jetën. Madje, Pjerin Guraziu do të pushkatohej si armik pa asnjë faj, kur Sabri Dajlanit, Feti Dizdarit e Pal Mirashit, shpejt mbas Ballkaniadës (e më pas edhe Galip Sojliu pa asnjë mëshirë do t'u vihehin prangat si të burgosur politikë.

Dy vjet më parë, dhjetor 1944, Shqipëria ishte bërë vendi i parë në Evropën e mbasluftës që kishte pushkatuar një rekordmen të atletikës së lehtë, sportistin e madh shqiptar, Sejfedin Biçakun, të cilin ashtu të vrarë do ta ekspozonte në mes të qytetit të Kuëksit si armik, duke tmerruar popullin. Ishte rekordmeni shqiptar i trehëpëshit, rekor që nuk do ta mbërrinte asnjë shqiptar në këto lojëra të Ballkanit, 13.56, vendosur qysh më 1938 dhe vetëm 18 cm më pak se Kalistrati kampion i Ballkanit, rekordi i Biçakut do të thyhej vetëm në 1952 nga Vlash Koljaka, ndërsa rekordmeni ynë i madh do të vononte 46 vjet që të shndërrohej në dëshmor të atdheut të tij. Ende sot, pak kush di për të dhe jo vetëm kaq. Po aq humanizmi i Ballkaniadës 1946, në Shqipërinë organizatore shpejt do të kalonte në arkivin e fshehtë për të mos u përmendur jo vetëm një: Shqipëria- Kampione e Ballkanit në futboll. Edhe kësaj, duke i zhdukur për dekada katër emra të spiktara: Giacomino Posellin dhe Dodë Tahirin, i pari italian i riadhesuar, i dyti shqiptar shtetas i Jugosllavisë, gjithashtu i rikthyer atje, më pas Bahri Kavajën, për shakk të arratisjes së tij si dhe Ljubisa Brocicin, trajneri jugosllav që drejtoi Shqipërinë. Nuk është vonë as sot, për të nderuar ballkaniadasit shqiptarë të vitit 1946 që e vendosën një gur të fuqishëm në themelet e sportit shqiptar.

Përgatiti Vangjel Buda

Vlash PAMBUKU

# Shpallen fituesit e anketave sportive të vitit

- *Ishte një festë sportive pa ngjyra politike*
- *Mesazhet e sportit bashkojnë rivalët*

Në shtëpinë e ushtarakëve të qytetit në prani të sportistëve, trajnerëve, veprimtarëve të sportit, ku merrnin pjesë kryetari i bashkisë z. Fadil Nasufi, kandidati për kryetar bashkie z. Sali Hoxha, anëtarë të këshillit bashkiak, shpallën fituesit e dy anketave sportive të vitit 2006:

*Anketa e 38-të "Sportistët më të mirë të vitit".*

*Anketa e 26-të "Trajnerët më të mirë të vitit"*

## PAK HISTORIK

Në vitin 1968 klubi sportiv "Tomori" mori nismën e bukur organizimin e anketës sportive: "Sportistët më të mirë të vitit 1968. Ishte e para nismë në vendin tonë që merret nga një klub sportiv. Nisma u përqafua edhe nga klubet e tjera sportive. E ndërsa ato ecën pak vite dhe ndalën, nisma jonë ka ecur duke e thelluar traditën.

Tashmë kanë kaluar vite, e jo pak 38 nga organizimi i anketës së parë, ku janë përfshirë dhjetëra e dhjetëra sportistë dhe trajnerë.

Dhe përsëri ashtu sikundër çdo vit shpallën fituesit e anketave sportive nëpërmjet konferencierit të spektaklit, gazetarit sportiv Edi Spahiu.

Fituesit nderohen me stimujt material.

## Ja fituesit e anketave sportive

### GJIMNASTIKË

#### Fitues ankete:

*Trajneri:* Edison Ikonomi, ekipi kampion të rritur;

*Gjinnast:* Valter Mbjeshova, kampion, fitues i 5 medaljeve;

*Gjinnast:* Klodian Toska, nënkampion;

*Trajner:* Gëzim Monopati, kampion të rinj;

*Gjinnast:* Pandeli Kondi, kampion të rinj, medalje ari në veprimtarinë ndërkombëtare në Çeki.



Gjinnastët kampionë me trajner Edison Ikonomi

### MUNDJE

#### Fitues ankete:

*Trajneri* Mjeshtri i Merituar Hajri Dhelpra, nënkampion për të rriturit, kampion të rinj;

*Mundësi* Edison Therepeli, kampion të rritur dhe të rinj;

*Mundësi* Lutian Dhelpra, nënkampion të rritur.



Trajneri i Mundjes, Mjeshtri i Merituar Hajri Dhelpra. Me talentet e ardhmja e mundjes

### PINGPONG

#### Fitues i anketave:

*Trajneri* Xhoxhi Skufi, nënkampion të rritur;

*Pingpongiste* Erida Skufi, kampione të reja;

*Pingpongisti* Ilir Shabani, fitues në kupën e Shqipërisë.



Pingpongistët Erida Skufi dhe Ilir Shabani

### QITJE

#### Fituese të anketës:

*Trajnere* Fatbardha Myzyri, kampione në ushtrimet e pushkës të reja, të rinj,

nënkampion të rritur;

*Qitësja* Sonila Muço, nënkampionia të rritura, kampione të reja.



Fatbardha Myzyri, trajneria e qitjes


### PESHËNGRITJE

#### Vlerësim të veçantë:

*Trajneri* Mihal Hoco, në kampionatin e të rinjve vendi i 4;

#### Fitues i anketës:

*Shtangisti* David Gjika, nënkampion të rritur, kampion të rinj.



Shtangisti David Gjika

### BOKS

#### Vlerësim të veçantë:

*Trajneri* Gentian Bega, ekipi i para të rinjve vendi i 4;

*Boksieri* Emiljano Hoxha, kampion të rinj;

*Boksieri* Perikli Kristiani, kampion të rinj.